



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR**  
**TIRANË**

Nr. 16 Regj.Them.  
Datë 31.05.2021 Regj.Them.

Nr. 12 VENDIMI  
Datë 08.06.2021 VENDIMI

**V E N D I M**

**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me trup gjykues të përbërë nga:

**Gjyqtare:** Emona MUÇI (*Relatore*)  
**Gjyqtar:** Gentian MEDJA (*Anëtar*)  
**Gjyqtare:** Manjola XHAXHO (*Anëtare*)  
**Gjyqtar:** Asim VOKSHI (*Anëtar*)  
**Gjyqtare:** Alma KOLGJOKA (*Anëtare*)

me sekretare gjyqësore Erjona Torba, sot më datë **08.06.2021**, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim bashkimin e çështjen me nr.16 Akti, datë **31.05.2021** dhe çështjen me nr.20, datë 03.06.2021 që i përket:

**PADITËS:**

**Kandidati i propozuar nga zgjedhësit z.Boiken Abazi**, kandidati i pavarur, subjekt zgjedhor i regjistruar për Qarkun Tiranë, përfaqësuar vetë në gjykim.

**Subjekti Zgjedhor Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN)**, përfaqësuar me Autorizimin datë 07.05.2021, nga Marash Logu.

**IPADITUR:**

**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, përfaqësuar në gjykim me Autorizimin nr. 5659 Prot., datë 08.06.2021 nga Z. Olsi Peto.

**PERSON I INTERESUAR:**

**Subjekti Zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim**, në mungesë në gjykim.

**Subjekti Zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë** përfaqësuar në gjykim me Autorizimin nr.180 Prot., datë 27.05.2021 Maringlen Legisi.

**OBJEKTI në padinë e parë:**

- 1.Kundërshtimin e Vendimit Nr.91, datë 27.05.2021 të KQZ/KAS, që rrëzoi ankesën e depozituar nga subjekti zgjedhor, kandidati i pavarur Boiken Abazi.
- 2.Në ankesën e depozituar në KQZ/KAS nga subjekti zgjedhor, Boiken Abazi, kërkohej “Kundërshtimi i vendimit nr. 343, datë 04.05.2021 ‘Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për Rezultatit në zonën zgjedhore Qarku Tiranë””.
- 3.Gjykimin e çështjes në themel, duke vendosur pranimin e plotë të padisë.
- 4.Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve për Qarkun Tiranë;
5. Përsëritjen e zgjedhjeve në Qarkun e Tiranës.

**OBJEKTI në padinë e dytë:**

1. Kundërshtimi i vendimit Nr. 91, datë 27.05.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) për rrëzimin e kërkesës ankimore Nr. 39 të subjektit zgjedhor Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim (PD-AN).
- 2.Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara në datën 25.04.2021 në zonën zgjedhore Qarku Tiranë.
- 3.Urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Tiranë.

**BAZA LIGJORE në padinë e parë:**

Neni 145 e në vijim të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i përditësuar.

**BAZA LIGJORE në padinë e dytë:**

Nenet 1, 18, 35, 42, 45 dhe 64 të Kushtetutës së Shqipërisë. Nenet 6, 8 dhe neni 3, Protokollin 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Pikat 27 dhe 49 të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore. Nenet 136, 137, 145, 152, 153 156, 160

dhe 161 të Kodit Zgjedhor. Nenet 14, 223 dhe 224 të Kodit të Procedurës Civile. Nenet 6 dhe 7 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Nenet 3 dhe 6 të Vendimit Nr. 9, datë 24.12.2020 të KQZ-së.

***Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, administroi provat në seancë gjyqësore, dëgjoi pretendimet e fundit të palëve ndërgjyqëse:***

**Pala paditëse, Subjekti Zgjedhor Subjekti Zgjedhor z.Boiken Abazi:**

- *Pranimin e padisë së parë sipas objektit.*

**Pala paditëse, Subjekti Zgjedhor Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN):**

- *Pranimin e padisë së dytë sipas objektit.*

**Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:**

- *Rrëzimin e padisë së ngritur nga subjektet politike Biken Abazi dhe Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 91, datë 27.05.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanskioneve (KAS).*

**Pala e Interesuar, Subjekti Zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë:**

- *Rrëzimin e plotë të padive të ngritur nga Boiken Abazi dhe Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, si të pabazuar në ligj dhe në prova.*

**Pala e Interesuar, Subjekti Zgjedhor Partia Socialiste për Integrim,**

- *pavarësisht njoftimit të rregullt për datën dhe orën e procesit gjyqësor e la në mungesë gjykimin e tij dhe shpalljen e vendimit.*

**VËREN:**

**I. Procedura e ndjekur:**

**1.** Pala paditëse në padinë e parë, **Subjekti Zgjedhor z.Boiken Abazi** i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor me kërkesëpadi më datë 31.05.2021, duke kërkuar “*1.Kundërshtimin e Vendimit Nr.91, datë 27.05.2021 të KQZ/KAS, që rrëzoi ankesën e depozituar nga subjekti zgjedhor, kandidati i pavarur Boiken Abazi. 2.Në ankesën e depozituar në KQZ/KAS nga subjekti zgjedhor, Boiken Abazi, kërkohej “Kundërshtimi i vendimit nr. 343, datë 04.05.2021 ‘Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për Rezultatit në zonën zgjedhore Qarku Tiranë.3.Gjykimin e çështjes në themel, duke vendosur pranimin e plotë të padisë. 4.Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve për Qarkun Tiranë; 5. Përsëritjen e zgjedhjeve në Qarkun e Tiranës”.*

**2.** Pala paditëse në padinë e dytë, **Subjekti Zgjedhor Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN)**, i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor me kërkesëpadi më datë 03.06.2021 (depozituar nëpërmjet shërbimit postar), duke kërkuar “*1. Kundërshtimi i vendimit Nr. 91, datë 27.05.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanskioneve (KAS) për rrëzimin e*

*kërkesës ankimore Nr. 39 të subjektit zgjedhor Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim (PD-AN). 2.Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara në datën 25.04.2021 në zonën zgjedhore Qarku Tiranë. 3.Urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Tiranë.”*

3. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor në datën 03.06.2021, në zbatim të neneve 57, 158/a (ë) të Kodit të Procedurës Civile dhe neneve 154 e 155 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë me vendimin e ndërmjetëm ka vendosur *“Bashkimin e çështjes së paraqitur më pas me nr.20 akti, datë regjistrimi 03.06.2021, me paditës Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD-AN) me çështjen zgjedhore të regjistruar më parë e cila mban nr. 16 akti, datë regjistrimi 31.05.2021, me paditës Boiken Abazi”*.

## **II. Faktet e Çështjes:**

4. Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, kishte caktuar datën 25 Prill 2021, për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

5. Në datën 25.04.2021, në 12 Zonat Zgjedhore në Republikën e Shqipërisë u zhvilluan zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë. Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave KZAZ-të përkatëse plotësuan e miratuan tabelat përmbledhëse të rezultateve për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë të zonave përkatëse. Zona Zgjedhore Qarku Tiranë ka 18 (tetëmbëdhjetë) zona të administrimit zgjedhor, përkatësisht ZAZ nr. 26, ZAZ nr. 27, ZAZ nr. 28, ZAZ nr. 29, ZAZ nr. 30, ZAZ nr. 31, ZAZ nr. 32, ZAZ nr. 33, ZAZ nr. 34, ZAZ nr. 35, ZAZ nr. 36, ZAZ nr. 37, ZAZ nr. 38, ZAZ nr. 39, ZAZ nr. 40, ZAZ nr. 41 ZAZ nr. 42 dhe ZAZ nr. 43.

6. Me vendimin nr. 343, datë 04.05.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) vendosi miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për subjektet zgjedhore, për zonën zgjedhore Qarku Tiranë në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021. Në përfundim të procesit të numërimit të votive për subjektet zgjedhore, u konstatuan 466.058 fletë të vlefshme votimi dhe 18.399 fletë votimi të pavlefshme.

7. Sipas tabelës përmbledhëse rezultojn se kandidati i pavarur Boiken Abazi, ka siguruar 2993 fletë votimi të vlefshme. Ndërsa subjekti zgjedhor Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN) ka siguruar 182335 fletë të vlefshme votimi.

**8. Kundër vendimit nr. 343, datë 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) ka paraqitur ankim kandidati i pavarur z. Boiken Abazi duke pretenduar se:**

- *Kryetaret e shtatë KZAZ-vë kanë penguar hyrjen e vëzhguesve, brenda Vendeve të Numërimit të Votave (VNV-ve) përkatëse gjatë kohës së pranimit të kutive në VNV-të, duke mos lejuar vëzhguesit të monitorojnë procesin e pranim-dorëzimit të kutive të votimit në kundërshtim me Kodin Zgjedhor.*
- *Prania në masë brenda VNV-ve, e personave të paautorizuar (të pa akredituar), përkatësisht familjarë dhe mbështetës të shtabit të kandidatëve të subjekteve të tjera zgjedhore ka shkaktuar tensione, duke ndërhyrë me fjalë deri në përdorimin e dhunës fizike.*

- *Ka pasur shkelje që lidhen me vota të pavlefshme. Vëzhguesit e kandidatit të pavarur z. Boiken Abazi kanë konstatuar raste kur janë shpallur të pavlefshme shumë fletë votimi pa asnjë arsyetim, dhe kontestimet e atypëratyshme nga vëzhguesit e kandidatit të pavarur z. Boiken Abazi nuk janë marrë parasysh nga grupi i numërimit dhe kryetari i KZAZ-së, përkatëse. Janë konstatuar raste të shumta të përdorimit të stilolapsit nga ana e grupeve të numërimit mbi tavolinën e numërimit dhe mbi fletët e votimit të cilat ndikojnë te rritja e numrit të pavlefshëm të tyre.*
- *Është konstatuar mbulimi me gisht gjatë procesit të numërimit, i katrorit nën numrin 13 që i përkiste kandidatit të pavarur z. Boiken Abazi. Në ekranin e tavolinave të numërimit nuk është vendosur pamja e plotë e fletës së votimit.*
- *Refuzimi i dhënies së kopjes së procesverbaleve të nënshkruara të rezultateve të numërimit të QV-ve të vëzhguesit të kandidatit të pavarur z. Boiken Abazi dhe mos vendosja e këtyre procesverbaleve në hapësirën e përcaktuar nga KZAZ-ja përkatëse kanë cënuar dispozitën e përcaktuar në Kodin Zgjedhor. Është konstatuar mungesa e subjektit zgjedhor kandidatit të pavarur z. Boiken Abazi, në tabelën përmbledhëse të rezultateve të një KZAZ-je.*
- *Në fillim të procesit të numërimit masivisht, KZAZ-të e qarkut nuk janë treguar në kamera ana e fletëve të votimit me vulën. Nuk janë thënë me zë, si dhe nuk janë paraqitur në kamera të Grupeve të numërimit në tavolinat e numërimit, apo ndonjë formë tjetër të dukshme: numri i votuesve të QV-së, të fletëve të votimit në kuti/QV, apo edhe numri i fletëve të papërdorura, kodet e sigurisë së kutisë.*
- *Nga fotografitë e bëra prej vëzhguesve të akredituar të kandidatit Boiken Abazi dhe nga pamjet filmike, janë paraqitur 164 fotografi të fletëve të votimit ku është vendosur një “X” i dytë shtesë, ose i tretë, në ato fletë votimit ku është vendosur një “X” për kandidatin e pavarur Boiken Abazi.*
- *Ekzistenca e një indicje në shkollën “Arben Broci” në Tiranë, ku mund të jenë hapur kutitë e votimit dhe manipuluar fletët e votimit para se ato të dërgoheshin në Vendin e Numërimit të Votave.*
- *Shumë qytetarë të qarkut Tiranë u është mohuar e drejta për të votuar për shkak se ishin infektuar me COVID-19, dhe organet e shtetit dhe KQZ-ja nuk u ndërmorën masa për t’ia mundësuar votimin në spitale apo në vendet ku ishin karantinuar.*
- *Qeveria ndërmori masën e për karantinë dy javore për qytetarët që ktheheshin nga Greqia dhe Maqedonia e Veriut, duke ndikuar negativisht drejtpërdrejtë tek e drejta e votës së këtyre qytetarëve.*
- *Presioni ndaj qytetarëve përmes vjedhjes së të dhënave personale në një data bazë që përmbante afërsisht 900 000 qytetarë shqiptarë ka cenuar parimet e përgjithshme të zgjedhjeve si dhe përbën një vepër penale që ndikon në procesin zgjedhor.*
- *Qytetarëve të Shqipërisë që jetojnë jashtë shtetit i’u mohua e drejta e votës edhe pse kjo është një e drejtë kushtetuese dhe ligjore e përcaktuar edhe në ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor.*

**9. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim subjekti zgjedhor Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN), e cila pretendon se:**

- *Gjatë periudhës mars-prill 2021, PD ka depozituar 50 kallëzime penale në Prokurorinë e Posaçme SPAK dhe 130 në prokuroritë e rretheve, të cilat kanë të bëjnë me vepra penale të tilla si “Shpërdorim detyre”, “Korrupsion aktiv në zgjedhje”, “Përdorim i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” etj;*
- *Sipas të dhënave të publikuara në media nga organizata të shoqërisë civile, bashkitë Durrës, Tiranë, Kavajë, Lezhë, Rrogozhinë, Vorë, Krujë, Laç dhe Mirditë u shpërndanë 40 milionë euro për familjet e prekura nga tërmeti i Nëntorit 2019. Janë përdorur në mënyrë të paligjshme burimet shtetërore për devijimin e vullnetit të zgjedhësve;*
- *Nëpunësit civilë ishin nën presion të vazhdueshëm për të mbështetur kandidatët socialistë, në të kundërt mund të shkarkoheshin nga detyra.*
- *Nga viti 2017 e në vijim, Qeveria ka nxjerrë 28 vendime duke shtuar numrin e punësimeve në strukturat e qeverisjes qendrore me 16645 pozicione të reja, për përfitim politik, duke devijuar vullnetin;*
- *Deputetë të ndryshëm të Partisë Socialiste shpërndanë leje legalizimi në kundërshtim me përcaktimin e Kodit Zgjedhor dhe Vendimit Nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator të KQZ-së.*
- *Sipas Ministrisë së Financave, për periudhën janar-prill 2021 janë paguar 20 milionë euro më shumë për paga krahasuar me në njëjtën periudhë të vitit 2020;*
- *Në 11.02.2021, u publikua në Fletoren Zyrtare një vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore me nr. 101, datë 15.12.2020 “Autorizim i ndihmës shtetërore për fuqizimin e të rinjve dhe të rejave”, nëpërmjet të cilit autorizohej Bashkia Tiranë të mbështeste me grante të rinjtë e prekur nga pasojat e shkaktuara nga tërmetet e nëntorit 2019, si dhe pandemia COVID-19. Ndihma do të jepej në formën e grantit në vlerën 16 milionë lekë ose 131 mijë euro, ku çdo përfituese do të mbështetet me grant të drejtpërdrejtë rreth 800.000 lekë ose 6.6 mijë euro;*
- *Me Vendimin Nr. 1185, datë 24.12.2020 të Këshillit të Ministrave “Mbi përcaktimin e metodologjisë dhe procedurave për monitorimin e trafikut në fushën e hidrokarbureve”, qeveria shpalli një koncesion me vlerë 100 milionë Euro dhe kohëzgjatje 10 vite;*
- *Me qëllim ndikimi në shtresat vulnerabël, bazuar në të dhënat zyrtare të Ministrisë së Financave, qeveria ka paguar për ndihmën ekonomike për familjet në nevojë 313,763,706 lekë më shumë për periudhën janar-prill 2021, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020;*
- *Në datën 11 prill, media publikoi një bazë të dhënash të 910.000 zgjedhësve që përdorte Partia Socialiste në Tiranë, duke bërë publike të dhëna personale si numri i ID-ve, vendi i banimit, numri i telefonit dhe bindja politike e shprehur në zgjedhjet e kaluara dhe projeksionet për zgjedhjet e 2021; këto të dhëna janë marrë nga të dhëna shtetërore që qytetarët i kanë vënë në dispozicion në portalin e-albania për të marrë shërbime gjatë pandemisë, apo në institucione të tjera shtetërore për të marrë shërbime nga administrata;*

- Në 17 prill 2021, Kryeministri Edi Rama gjatë një takimi elektoral në qytetin e Durrësit, falenderoi patronazhistët për punën e bërë. Fakti që vetë Kryeministri e pranoi këtë fenomen dhe e normalizoi atë përmes falenderimeve, tregon se databaza të njëjta me ato të publikuara kanë ekzistuar në të gjithë Republikën e Shqipërisë. Skandali me të dhënat personale u evidentua edhe në Raportin paraprak të OSBE/ODIHR-it;
- Komiteti Teknik i Ekspertëve pranë Ministrisë së Shëndetësisë, vetëm 1 javë para zgjedhjeve, nxori një vendim që detyronte emigrantët që vinin nga Greqia apo Maqedonia e Veriut të karantinoreshin detyrimisht për një periudhë 2-javore. Ky vendim pengonte efektivisht mbi 500 mijë emigrantë shqiptarë që jetojnë në Greqi për të ushtruar të drejtën e votës, në mënyrë diskriminuuese;
- Ndryshimet e njëanshme të Kodit Zgjedhor nga Partia Socialiste, duke shkelur marrëveshjen konsensuale me KQZ-në, u evidentuan si problematikë edhe nga Misioni i OSBE/ODIHR. Në opinionin e tyre të përbashkët, Komisioni i Venecias të Këshillit të Evropës dhe ODIHR-i shprehën keqardhje që procedurat e miratimit të ndryshimeve në Kushtetutë dhe në Kodin Zgjedhor kishin qenë jashtëzakonisht të nxituara dhe që nuk ishin paraprirë nga një proces i duhur konsultimi.
- Numri i votave të pavlefshme ishte 83.026, ose 5 % e numrit total të votuesve dhe ky fakt është ndikuar nga përmbajtja e fletës së votimit me numra dhe jo me emrat e kandidatëve, duke krijuar konfuzion ditën e zgjedhjeve;
- Ligji diskriminon kandidatët gjatë procesit zgjedhor, duke u lejuar vetëm kryetarëve të partive, por asnjë kandidat tjetër, që të kandidojnë deri në katër zona zgjedhore, ndërkohë që kandidatët e tjerë mund të kandidojnë vetëm në një zonë, gjë që përbën shkelje të së drejtës së kandidimit në kushte të barabarta;

**10. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve me vendimin nr.91, datë 27.05.2021 ka vendosur:** 1. Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr. 39, datë 09.05.2021 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD - AN);

2. Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr. 51, datë 09.05.2021 të paraqitur nga subjekti zgjedhor kandidati i mbështetur nga zgjedhësit, z. Boiken Abazi.

3. Lënien në fuqi të vendimit nr. 343, të datës 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve të zonës zgjedhore qarku Tiranë për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”;

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, brenda 5 ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

11. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS në vijim), ndër të tjera, ka arsyetuar se:”...(…) Në lidhje me kërkimin e ankuesve për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në këtë qark, është argumentuar: \_ Neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si tipar kryesor për shkeljet e ligjit, me qëllim që ato të trajtohen si shkak për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, peshën e tyre dëmprurëse

mbi zgjedhjet. Në këto raste dëmi mund të vijë edhe nga një shkelje e vetme, por tronditëse për zgjedhësit ose rregullshmërinë e procesit (p.sh. cënimi i integritetit të kutive të votimit - nenet 115 dhe 138 të KZ). Përgjatë zgjedhjeve mund të ndodhin parregullsi apo shkelje të shumta, të lehta ose të rënda, të cilat mund të kenë lidhje me aspekte të veçanta të procesit, por jo të gjitha mund të cilësohen “shkelje që çënojnë rëndë procesin zgjedhor”. Shkelje që çënojnë rëndë procesin zgjedhor janë vetëm shkeljet që ose i pengojnë/largojnë zgjedhësit në masë nga votimi, ose që i detyrojnë ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që tjetërsojnë në masë votën e hedhur. Votimi familjar p.sh. që është konstatuar shpesh nga misionet vëzhguese të OSBE/ODIHR-it si shkelje e procesit zgjedhor nuk është konsideruar nga ata kurrë si shkelje që shkakton pavlefshmërinë e zgjedhjeve, sepse ata nuk e kanë vëzhguar asnjëherë këtë shkelje në masën e vet kritike. Po kështu, shitblerja e votës që gjithashtu është kritikuar në një numër zgjedhjesh dhe që këtë herë u cilësua si “problem i përhapur”, nuk u vëzhgua prej tyre në masë kritike....Kodi Zgjedhor ka përpunuar mjete ligjore të ndryshme për shkelje të ndryshme. Për një pjesë prej tyre mjeti ligjor është gjoba administrative (shkeljet e kryera nga media, subjektet zgjedhore, përfaqësuesit e institucioneve), për një pjesë janë masat disiplinore (shkarkimi etj.), për një pjesë është ndjekja penale (shitblerja e votës, shpërdorimi i detyrës, korrupsioni aktiv dhe pasiv në zgjedhje etj.), por për asnjërën prej tyre Kodi nuk ka përcaktuar si mjet ligjor pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Kjo është arsyeja pse ekzistenca e një apo më shumë shkeljeve, qofshin këto edhe të rënda, nuk është shkak i vetëmjaftueshëm për të kërkuar pavlefshmëri. Kjo është arsyeja pse kërkesat për pavlefshmëri duhet të shoqërohen patjetër me argumentimin juridik që vërteton se shkelja e pretenduar është “shkelje që çënon rëndë procesin zgjedhor”, sikurse duhet të shoqërohen edhe me provën se sa dhe si e ka çënuar ajo procesin zgjedhor.

Në lidhje me provat e tjera KAS ka analizuar se:” ...(...) Nga pohimet e avokatit të subjektit ankues PD-AN –së, (shih procesverbalin e shqyrtimit të kërkesës ankimore për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në zonën zgjedhore Qarku Tiranë) rezulton se provat e paraqitura prej këtij subjekti ankues dhe të pranuarat për shqyrtim nga KAS-i nuk faktojnë sa raste shitblerje vote, sa raste lejesh legalizimi, sa raste punësimi, sa raste mohimi të së drejtës për votim për emigrantët, sa raste votimi të shumëfishtë ka pasur në qarkun e Tiranës. Po kështu, ato nuk faktojnë se sa secili prej këtyre fenomeneve, apo edhe i formave të tjera të përdorimit të burimeve shtetërore, i dhënies së ndihmave apo i ushtrimit të presionit mbi zgjedhësit kanë ndikuar në pengimin/largimin e zgjedhësve nga votimi, në detyrimin e votuesve që të votojnë në një mënyrë të caktuar, apo tjetërsimin e votës. .... Subjekti ankues ka depozituar si prova në mbështetje të pretendimeve të veta 7 (shtatë) kallëzimet penale. Kallëzimet penale të depozituara si prova nuk provojnë në asnjë rast ekzistencën apo vërtetësinë e fakteve apo ngjarjeve të përshkruara në to. Ato provojnë vetëm faktin se PD për zonën zgjedhore Qarku Tiranë ka depozituar së paku shtatë kallëzime penale.... Kodi Zgjedhor përcakton në pikën 4 të nenit 91: “4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore”. ...Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1076,



datë 24.12.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e ministrisë së shëndetësisë dhe njësinë mjekësore ushtarake pranë spitalit universitar të traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e forcave të armatosura”, të ndryshuar” ka dalë brenda periudhës së ndalimit dhe sjell rritje pagash për kategori të caktuara punonjësish publikë. ...Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1044, datë 18.12.2020 “Për një shtesë në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar” është miratuar përpara fillimit të periudhës së ndalimit, prandaj nuk përbën shkelje, sikurse miratimi i vendimit nr. 1102, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2021” nuk përbën shkelje, sepse ai është vendim procedurash dhe kriteresh lidhur me një fond që është dhënë me ligjin për buxhetin e vitit 2021. ...Shkelja e kryer në favor të subjektit zgjedhor PS me nxjerrjen e VKM nr. 1076, datë 24.12.2020 formon kundërvajtje administrative sipas nenit 172 të Kodit Zgjedhor. ...Nga pohimet e përfaqësuesve administratës së KQZ-së rezulton se PD nuk ka bërë ankim në KQZ për këtë shkelje. Në këtë kategori pretendimi bën pjesë edhe vendimi 101, datë 15.12.2020 “Autorizim i ndihmës shtetërore për fuqizimin e të rinjve dhe të rejave”. KAS konstaton se ky vendim nuk përbën kundërvajtje administrative, sepse nuk ka dalë brenda periudhës së ndalimit. ...Lidhur me pretendimin e subjektit ankues PD-AN të shprehur në paragrafin nr. 51 të kërkesës së tyre ankimore, për shpalljen e koncesionit me vendimin nr. 1185, datë 24.12.2020 të Këshillit të Ministrave “Mbi përcaktimin e metodologjisë dhe procedurave për monitorimin e trafikut në fushën e hidrokarbureve”, KAS vëren se neni 3, pika 4 e vendimit nr. 9 , datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator i referohet ndalimit të ‘dhënies së koncensionit’. Dhënia e koncensionit është procedura që kryhet në momentin që nënshkruhet kontrata midis koncensiondhënësit dhe koncensionarit. Shpallja e tenderit në vetvete nuk formon dhënie koncensionit, por është hapi i parë në fillimin e procedurave shumë mujore që përfundojnë me kontratën. Për këtë arsye, ky veprim nuk formon shkelje....Një grup provash të depozituara nga subjekti ankues ilustronë debatin mediatik rreth të ashtuquajturit “skandali i patronazhistëve”, i cili ka lidhje me një bazë të dhënash prej rreth 900 mijë zgjedhësish, ku ishin fiksuar, ndër të tjera, dhe preferencat e aluduara politike të tyre. Nga tërësia e të dhënave të bazës janë me interes për zgjedhjet të dhënat për preferencat politike. Këto të dhëna janë dukshëm produkt i punës së “patronazhistëve”, mbështetur në “eksplorimin” e tregut politik nga strukturat partiake. Kjo metodë eksplorimi politik bën pjesë në taktikat tradicionale të partive politike, ndonëse metodat ndryshojnë nga njëra parti në tjetrën. Pjesa tjetër e të dhënave janë të dhëna personale, që janë siguruar në mënyrë të paqartë, përveç listës me emra zgjedhësish e cila është publike dhe u ofrohet partive politike në zbatim të dispozitave të Kodit Zgjedhor (pika 2 e nenit 60). Përdorimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale rregullohet nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale. Rrethanat e lidhura me skandalin e patronazhistëve provojnë shkallën e ulët të respektimit të rregullave të vendosura nga ky ligj në Shqipëri. Provat e paraqitura në këtë kontekst provojnë sensibilitetin ndaj ngjarjes, por jo ndikimin e saj tek votuesit. Subjekti ankues nuk solli prova se publikimi mund të kishte intimiduar zgjedhësit dhe t’i kishte mbajtur ata larg

nga procesi i votimit. Pjesëmarrja në këto zgjedhje në zonën zgjedhore Qarku Tiranë ishte 484777 (53,24%), nga 423717 (49,91%) që ka qenë në vitin 2017. ...Në ditën e votimit misioni vëzhgues i OSBE/ODIHR-it vuri re në disa qarqe “grupe të rinjsh që grumbulloheshin jashtë qendrave të votimit dhe dukej se kontrollonin zonën dhe mbanin shënim se kush votonte”. Edhe kjo formë patronazhi është pjesë e taktikave elektorale të partive të mëdha, pjesë e metodave që kompletojnë bazat e të dhënave të partive politike. Por edhe për këtë nuk u servirën prova që të tregonin intimidimin e zgjedhësve apo detyrimin e tyre për të votuar në një mënyrë të caktuar. ...Kodi Zgjedhor ka parashikuar mundësinë për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë shtetit që të votojnë në zgjedhjet për Kuvendin. Komisionit Rregullator i është lënë kompetenca e posaçme që të vendosë “zhvillimin për herë të parë të votimit nga jashtë vendit, mbështetur në raportimin e Komisionerit për plotësimin e masave tekniko-organizative që mundësojnë votimin” (shkronja “ç” e pikës 2 të nenit 20). Në zgjedhjet e 25 prillit 2021 Komisioni Rregullator nuk e shfrytëzoi këtë kompetencë, duke mos e ligjësuar mundësinë e kësaj kategorie zgjedhësish të votonin në distancë. Në këto zgjedhje mund t’u shfrytëzonin këtë mundësi, nëse do bëhej e aplikueshme, vetëm 3613 zgjedhës nga 4572 shtetas të regjistruar me banim jashtë shtetit (të dhënat janë marrë nga KQZ-ja). Për shkak të mosaplikimit të votimit nga jashtë vendit, e drejta e tyre e votimit do të realizohej në këto zgjedhjeve vetëm nëpërmjet paraqitjes në qendrën e tyre të votimit. Ky modalitet votimi është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Pamundësia e votimit në distancë në këto zgjedhje për shtetasit shqiptarë me banim jashtë shtetit nuk formon shkelje. Atje ku nuk ka shkelje nuk ka pavlefshmëri. ...Subjekti ankues PD-AN ngriti pretendime kundrejt urdhrin nr.219, datë 19.04.2021 të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia” si një “vendim që pengoi efektivisht 500 mijë emigrantë shqiptarë që jetojnë në Greqi për të ushtruar të drejtën e votës”. Urdhri i sipërcituar është motivuar me nevojën për të dominuar përhapjen e epidemisë Covid19, në kushtet e “kontakteve më intensive në popullatë deri në përfundim të festës dhe veprimtarive fetare të lidhura me pashkët ortodokse”. Vetizolimi i personave që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë është një masë që është marrë në mënyrë të përsëritur që nga koha e nisjes së pandemisë dhe ka qenë e lidhur me statistikën e sëmundshmërisë dhe pritshmëritë nga ngjarje të caktuara. Mbyllja, izolimi apo vetizolimi kanë qenë masa dominuese edhe në rastet e festave të tjera zyrtare, publike ose fetare. Në kohën që u mor kjo masë Republika e Greqisë ka pasur në fuqi izolimin 14 ditor dhe numrin e kufizuar të hyrjeve për personat që hynin në territorin grek nga Shqipëria. Më vonë kjo masë u shndërrua në izolim 7 ditor. Shqipëria e mbajti në këmbë këtë masë deri më datën 3 maj 2021, d.m.th. deri pas festës. Urdhri nr.219, datë 19.04.2021 është kontestuar pa sukses në rrugë ligjore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe në Gjykatën Administrative të Apelit nga subjekti zgjedhor LSI. Subjekti ankues PD nuk ka shfrytëzuar mjetet ligjore për kontestimin e tij. Për këtë arsye, ligjshmëria e urdhrin nuk mund të vihet në diskutim. Efektet e një urdhri të ligjshëm nuk mund të formojnë shkelje. Pa shkelje nuk ka pavlefshmëri....Subjekti ankues PD-AN ka referuar se në ditën e zgjedhjeve kanë qenë 23.000 persona të infektuar me Covid-19, sipas të dhënave zyrtare nga Ministria e Shëndetësisë. Statistika e ofruar nuk saktëson se sa prej tyre kanë qenë zgjedhës për zonën e Tiranës. Për zgjedhësit e kësaj kategorie nuk ka qenë e mundur të votonin në kushtet e izolimit. Deklarata e Misionit vëzhgues të OSBE-ODIHR-it e ka quajtur

këtë “mohim de facto i të drejtës për të votuar” (faqe 7). Kodi Zgjedhor nuk parashikon mundësinë e votimit në distancë për zgjedhësit me vendbanim në Republikën e Shqipërisë, sikurse nuk autorizon KQZ-në që të përpunojë rregulla dhe të marrë masa për kryerjen e një votimi të tillë. Ky është kuadri ligjor për zgjedhjet. Kushtetueshmëria e tij nuk është sfiduar në rrugë ligjore. Edhe kushtetueshmëria e rregullave të izolimit për shkak të pandemisë Covid-19 nuk është sfiduar në rrugë ligjore. Kjo është arsyeja që Misioni vëzhgues e quan rezultatin mohim de facto, por nuk e quan shkelje. Atje ku nuk ka shkelje nuk ka pavlefshmëri....Një pretendim i veçantë ka lidhje me numrin anomalisht të lartë të fletëve të votimit të pavlefshme. Në zonën zgjedhore Qarku Tiranë numri i këtyre votave është 18399 ose 3.79% e numrit total të votave, por ky numër nuk mund të konsiderohet anomalisht i lartë, sepse mungon baza krahasuese. Pas ndryshimeve të fundit të Kodit Zgjedhor, votuesve iu dha mundësia të ushtronin të drejtën e tyre, duke hedhur dy vota, një për subjektet dhe një tjetër për kandidatët. Statistika nuk mund të krahasohet me votimet e kryera në Shqipëri, kur zgjedhësit kanë hedhur vetëm një votë. Në vlerësimin e subjektit ankues pavlefshmëria e lartë lidhet me kompozimin e fletës së votimit, gjë që përforcohet edhe nga deklarata e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve e datës 28.04.2021. Subjekti ankues nuk paraqiti asnjë fakt që të provonte lidhjen shkakësore midis vendimit të Kolegjit Zgjedhor për përmbajtjen e fletës së votimit dhe numrit të lartë të fletëve të pavlefshme. Deklarata e Komisionerit nuk e nxjerr këtë lidhje. Nga ana tjetër, ka një grup shkaqesh, të cilat duhet të mbahen në konsideratë gjatë analizës faktike rreth kësaj çështjeje si p.sh. fakti se në këto zgjedhje u votua me dy vota dhe probabiliteti i gabimit dyfishohej, fakti se fushata edukuese nuk pati efektin e dëshiruar ose nuk e davariti dot konfuzionin, fakti se kandidatët nuk harmonizuan dot mënyrën e re të votimit me taktikat elektorale, apo fakti se pavlefshmëria mund të ishte mënyrë votimi me dashje nuk mund të eliminohen vetëm për shkak se nuk përputhen me linjën e arsytimit të ankuesit. Misioni vëzhgues i OSBE/ODIHR-it identifikon si shkak të mundshëm vonesën në nisjen e fushatës informuese-edukuese. Pavlefshmëria e votës është pjesë e rregullave të votimit dhe numërimit të votave, nuk është mohim i së drejtës për të votuar (nuk ka mohim të së drejtës kur e drejta është ushtruar), nuk është shkelje e Kodit Zgjedhor, për pasojë nuk formon shkak për pavlefshmëri të zgjedhjeve. ...Subjekti ankues PD ka përfshirë në ankim një numër provash që bëjnë fjalë për individë të aluduar me rekorde të tmerrshme kriminale, të cilët janë të lidhur me interesa biznesi me shumicën qeverisëse dhe që janë përfshirë “si eksponentë që kontribuonin në këtë fushatë edhe për shkak të përfitimeve që kanë marrë nga PS”. Faktet e referuara në provat e depozituara dhe në shtjellimin e kërkesës ankimore nuk krijojnë lidhje faktike dhe logjike me shkelje të Kodit Zgjedhor dhe nuk provojnë kërkesën për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve. ...Subjekti ankues PD u tërhoq nga pretendimi i tij i shprehur në pikat 143-146 të kërkesës ankimore dhe e zëvendësoi atë me pretendimet që rezultuan nga administrimi i rezultateve të kryqëzimit të të dhënave nga pajisjet PEI të përdorura për identifikimin e votuesve. Subjektet ankuese në tërësi pretenduan se materiali shpjegues me statistikat e kontrollit të kryqëzuar të të dhënave PEI dhe dëshmia e Nënkomisioneres Shtetërore të Zgjedhjeve provojnë se ka patur parregullsi në administrimin e pajisjeve, të cilat kanë lidhje me regjistrimin e një gjurme daktiloskopike për më shumë se një identitet zgjedhësi, sikurse ka pasur raste të izoluara të personave me identitet dhe gjurmë daktiloskopike të njëjtë në dy qendra votimi të ndryshme. Në vlerësimin e përfaqësuesit të

subjektit ankues PD ky fakt provon se ekziston mundësia që një person i vetëm të ketë votuar në emër të shumë zgjedhësve dhe kjo e bën votimin në këto raste të pavlefshëm. Nga shqyrtimi i materialit të servitur nga KQZ-ja rezulton se ai jep informacion për fazën e parë të hetimit administrativ që neni 167/2 i KZ kërkon të kryhet “pasi të jetë shpallur rezultati përfundimtar, të jenë përmbyllur procedurat ankimore dhe zgjedhjet të kenë përfunduar” me qëllimin “për të verifikuar rregullsinë dhe saktësinë e veprimtarisë së administratës zgjedhore përgjatë administrimit të procesit dhe vlerësimit e numërimit të votave”. Rezultatet e servitura në material formojnë indicie për hetimin administrativ të KQZ-së, por nuk formojnë dot prova për të mbështetur pretendimin e subjekteve ankuese “ për raste të shumta të votimit të dyfishtë”. Materiali i servitur konstaton se për zonën zgjedhore ka një listë prej 123 rastesh të identifikuar me gjurmë daktiloskopike të dyshuara të njëjta nga pajisjet, por jo të përputhshme. Nëse gjurmët do ishin të përputhshme, atëherë pajisja do t'i kish deklaruar të përputhshme ato. Në 51 raste ky dyshim përqas gjurmën daktiloskopike me identitetin e njëjtë në dy qendra votimi të ndryshme. Mbi bazën e informacionit të përftuar nga materiali i servitur mund të ngrihen vetëm hipoteza për sjelljen e zgjedhësve të evidentuar por nuk mund të krijohet bindja për shkelje të provuara, aq më tepër për votim të dyfishtë. Nga palët në proces u argumentua se materiali i servitur provon se administrimi i procesit nga operatorët ka qenë i parregullt. KAS-i çmon se ky pretendim nuk ka lidhje me pretendimin për votim të shumëfishtë për të cilin ishte kërkuar marrja e provës. Ky material dhe stadi aktual i hetimit administrativ të KQZ-së nuk e provon pretendimin për votim të shumëfishtë. ...Subjekti ankues PD e ka mbështetur kërkesën e vet për pavlefshmëri edhe në deklaratën e Misionit vëzhgues të OSBE/ODIHR-it për gjetjet dhe konkluzionet paraprake, të datës 26.04.2021. Dokumenti përmban gjetje dhe të dhëna për shitblerjen e votës dhe për përdorimin e burimeve shtetërore, të cilat janë referuar në kërkesën ankimore. Në vlerësimin e këtij dokumenti KAS-i duhet të ndajë referencat me burim interlokutorët nga referencat me burim vëzhguesit e misionit. ... Deklarata eidenton faktin se “ministrat vijuan fushatën përgjatë veprimtarive zyrtare dhe me këtë publicitet i dhanë përparësi domethënëse partisë qeverisëse”, sikurse thekson se ishin shqetësim dhënia e incentivave dhe pretendimet për presion mbi nëpunësit publikë (faqe 2)...Dokumentit nuk përmban të dhëna specifike në lidhje me Qarkun Tiranë në këto aspekte. Gjetjet dhe konkluzionet paraprake të deklaratës janë të besueshme dhe të pranueshme. Sipas gjetjeve dhe konkluzioneve të kësaj deklarate të ODIHR-it, ka përhapje të fenomenit, blerja e votave është e pranishme si metodë së paku tek partitë e mëdha. Gjithsesi, përmasat e këtyre fenomeneve nuk formojnë, në gjykimin e misionit vëzhgues, shkak për pavlefshmëri, përndryshe deklarata nuk do t'i konsideronte zgjedhjet si zgjedhje ku “votuesit mund të zgjidhnin midis kandidatësh, të cilët mund të bënin lirshëm fushatë, me një kuadër ligjor që respekton liritë themelore” dhe ku “zgjedhjet ishin në përgjithësi të mirëorganizuar”(faqe 1). ...Lidhur me provat e paraqitura nga subjekti ankues z. Boiken Abazi, KAS-i konstaton se këto prova u morën në shqyrtim. Në rastin e pretenduar nga ankuesi se vëzhguesit e tij janë penguar të futen në KZAZ, ky fakt formon parregullsi procedurale, por jo pavlefshmëri të zgjedhjeve, për sa kohë që filtrat dhe garancitë e tjera kanë funksionua....Për sa i përket pretendimit të z. Abazi se në tabelën përmbledhëse të rezultateve mungon subjekti i trembëdhjetë, kandidati i pavarur; ky pretendim nuk mbështetet, pasi tabela është vetëm për subjektet zgjedhore parti ose koalicione. KAS vëren se subjekti ankues ka bërë

*një interpretim të gabuar të rolit dhe funksionit që ka tabela në administrimin e procesit. ...Pretendimi tjetër i z. Abazi lidhur me pamundësinë për të lexuar nga materialet e videove, një numër të kufizuar fletësh votimi, nuk mbështet dot kërkesën e tij për pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Vlen të theksohet se në një pjesë të rasteve, fleta tregon votë për subjekte të tjera, por nuk zbulon nëse ka patur shënime mbi kandidatët e pavarur. Këto raste nuk tregojnë tjetërsim në masë të rezultatit të zgjedhjeve, që do të ishte kusht për pavlefshmëri. ...Pamjet filmike të depozituara nga z. Abazi nuk kanë vlerë provuese për KAS, pasi ankuesi nuk ka identifikuar shkeljet që pretendon dhe nuk ka treguar se ku është prova që kërkon të merret nga KAS, duke i kërkuar këtij Komisioni ta identifikojë dhe ta nxjerrë atë. ...Lidhur me pretendimin e z. Abazi për 164 fletët e votimit, këto fletë të pretenduara janë fletë votimit të pavlefshme. Pretendimi i ankuesit se këto fletë janë bërë të pavlefshme në dëm të tij, i pashoqëruar me prova, është i barabartë me pretendimin e subjekteve të përfolura, se këto fletë votimi mund të kenë qenë në favour të tyre dhe janë bërë të pavlefshme duke shënuar “X” të dytë te kandidati i pavarur. Pretendimi është i pambështetur dhe i palogjikshëm, prandaj KAS e rrëzon atë. ...Pretendim tjetër i z. Abazi lidhet me një fletë votimi të gjetur në ambientet e shkollës “Arben Broci”. Prova e administruar, pamjet filmike të mbylljes së votimit dhe transportimit të materialit zgjedhor, provuan që integriteti i kutisë së votimit ishte i pacënuar. Ankuesi nuk solli asnjë provë të mbështetur në dokumentacion zgjedhor ku të provohet pretendimi i kundërt. Publikimet në rrjete sociale nuk provojnë dot provë dhe nuk mund të merren në konsideratë nga KAS. ...Subjekti ankues PD kërkoi nga KAS-i që të merrte në cilësinë e provës 19 informacione specifike nga institucione të ndryshme që veprojnë në territor. KAS-i, pasi shqyrtoi kërkesën vendosi me shumicë votash rrëzimin e saj.*

### **11.1 Përfundimisht KAS-i ka vlerësuar se:**

*“1. Shqyrtimi administrativ evidentoi raste shkeljesh të detyrimeve ligjore, të cilat formojnë kundërvajtje administrative. Shkeljet e evidentuara nuk provohet të kenë pasur ndikim në pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim, në ushtrimin e lirë dhe të pandikuar të së drejtës së tyre apo në tjetërsimin e vullnetit. Ato nuk formojnë “shkelje që cenojnë rëndë procesin zgjedhor” dhe as “shkelje që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore”, për pasojë nuk mund të shërbejnë si shkak për të shpallur zgjedhjet të pavlefshme në një ose më shumë qendra votimi.*

*2. Çdo ngjarje, fakt apo situatë e zhvilluar në zbatim apo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi nuk formon shkelje dhe nuk mund të shërbejë si shkak për të kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimit.*

*3. Çdo shkelje e pretenduar dhe që nuk mund të provohet se ka ndodhur ose se ka pasur ndikim mbi zgjedhjet në formën e pengimit të zgjedhësve për të marrë pjesë në votim, detyrimit të tyre për të votuar në një mënyrë të caktuar apo në formën e tjetërsimit të votës nuk mund të shërbejë si shkak për të kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimit”.*

### **III. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse përpara Kolegjit;**

12. Kandidati i propozuar nga zgjedhësit Boiken Abazi dhe subjekti zgjedhor Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN) pasi janë bërë me dije me vendimin e K.A.S. duke pretenduar se ky vendim është i pabazuar në ligj dhe në prova, i janë drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me paditë objekt gjykimi.

13. **Pala paditëse, Boiken Abazi**, në kërkesë padinë e parë dhe gjatë gjykimit, pretendoi të njëjtat shkaqe ankimi sikurse ka parashtuar dhe gjatë shqyrtimit administrativ të çështjes pranë KAS-it:

- a. *Kryetaret e shtatë KZAZ-vë kanë penguar hyrjen brenda Vendeve të Numërimit të Votave përkatëse gjatë kohës së pranimit të kutive në VNV, duke mos lejuar vëzhguesit të monitorojnë procesin e pranim-dorëzimit të kutive të votimit në kundërshtim me Kodin Zgjedhor.*
- b. *Prania në masë brenda VNV-e, e personave të paautorizuar (të pa akredituar), përkatësisht familjarë dhe mbështetës të shtabit të kandidatëve të subjekteve të tjera zgjedhore ka shkaktuar tensione, duke ndërhyrë me fjalë deri në përdorimin e dhunës fizike.*
- c. *Ka pasur shkelje që lidhen me vota të pavlefshme. Vëzhguesit e kandidatit të pavarur z. Boiken Abazi kanë konstatuar raste kur janë shpallur të pavlefshme shumë fletë votimi pa asnjë arsytim dhe kontestimet e atypëratyshme nga vëzhguesit e kandidatit të pavarur z. Boiken Abazi nuk janë marrë parasysh nga grupi i numërimit dhe kryetari i KZAZ-së, përkatëse. Janë konstatuar raste të shumta të përdorimit të stilolapsit nga ana e grupeve të numërimit mbi tavolinën e numërimit dhe mbi fletët e votimit të cilat ndikojnë te rritja e numrit të pavlefshme.*
- d. *Është konstatuar mbulimi me gisht gjatë procesit të numërimit, i katrorit nën numrin 13 që i përkiste kandidatit të pavarur z. Boiken Abazi. Në ekranin e tavolinave të numërimit nuk është vendosur pamja e plotë e fletës së votimit.*
- e. *Refuzimi i dhënies së kopjes së procesverbaleve të nënshkruara të rezultateve të numërimit të QV-ve të vëzhguesit të kandidatit të pavarur z. Boiken Abazi dhe mos vendosja e këtyre procesverbaleve në hapësirën e përcaktuar nga KZAZ-ja përkatëse kanë cënuar dispozitën e përcaktuar në Kodin Zgjedhor. Është konstatuar mungesa e subjektit zgjedhor kandidatit të pavarur z. Boiken Abazi, në tabelën përmbledhëse të rezultateve të një KZAZ-je.*
- f. *Në fillim të procesit të numërimit masivisht KZAZ-të e qarkut nuk janë treguar në kamera ana e fletëve të votimit me vulën. Nuk janë thënë me zë, si dhe nuk janë paraqitur në kamera të Grupeve të numërimit në tavolinat e numërimit, apo ndonjë formë tjetër të shqeshme: numri i votuesve të QV-së, të fletëve të votimit në kuti/QV, apo edhe numri i fletëve të papërdorura, kodet e sigurisë së kutisë.*
- g. *Nga fotografitë e bëra prej vëzhguesve të akredituar të kandidatit Boiken Abazi dhe nga pamjet filmike, janë paraqitur 164 fotografi të fletëve të votimit ku është vendosur një “X” i dytë shtesë, ose i tretë, në ato fletë votimit ku është vendosur një “X” për kandidatin e pavarur Boiken Abazi.*
- h. *Ekzistenca e një indicieje në shkollën “Arben Broci” në Tiranë, mund të jenë hapur kutitë e votimit dhe manipuluar fletët e votimit para se ato të dërgoheshin në Vendin e Numërimit të Votave.*

- i. Shumë qytetarë të qarkut Tiranë u është mohuar e drejta për të votuar për shkak se ishin infektuar me COVID-19, dhe organet e shtetit dhe KQZ-ja nuk u ndërmorën masa për t'ia mundësuar votimin në spitale apo në vendet ku ishin karantinuar.
- j. Qeveria ndërmori masën e për karantinë dy javore për qytetarët që ktheheshin nga Greqia dhe Maqedonia e Veriut, duke ndikuar negativisht drejtpërdrejtë tek e drejta e votës së këtyre qytetarëve.
- k. Presioni ndaj qytetarëve përmes vjedhjes së të dhënave personale në një data bazë që përmbante afërsisht 900 000 qytetarë shqiptarë ka cenuar parimet e përgjithshme të zgjedhjeve si dhe përbën një vepër penale që ndikon në procesin zgjedhor.
- l. Qytetarëve të Shqipërisë që jetojnë jashtë shtetit iu mohua e drejta e votës edhe pse kjo është një e drejtë kushtetuese dhe ligjore e përcaktuar edhe në ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor.

14. **Pala paditëse, Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN),** në kërkesë padinë e dytë dhe gjatë gjykimit, nëpërmjet përfaqësuesve të saj, pretendoi se:

- a. Vendimi i KAS-it është i cënueshëm, ai është marrë në shkelje të ligjit procedural dhe ligjit material, si dhe nuk është kryer një hetim i plotë e i gjithanshëm.

**Në lidhje me ligjin procedural:**

- b. Subjekti zgjedhor PD – AN gjatë hetimit administrativ ka vendosur në dispozicion të KAS çdo provë të siguruar nga vetë ajo, më qëllim identifikimin e të gjitha aspekteve të paligjshmërisë që karakterizuan procesin zgjedhor të 25 prillit.
- c. Në kushtet kur një pjesë e provave ka qënë e pamundur të sigurohet nga subjekti, ky i fundit i ka kërkuar KAS-it që ti drejtohet organeve të administratës shtetërore, për të vënë në dispozicion informacione, dokumente dhe çdo provë tjetër që kërkohet ose çmohet e nevojshme për hetimin administrativ.
- d. Kërkesa e subjektit është refuzuar nga KAS-i, kjo në shkelje flagrante të nenit 136, pika 1, gërma “c” dhe nenit 137 të Kodit Zgjedhor.

**Në lidhje me themelin e pretendimeve për pavlefshmëri:**

- e. Në lidhje me pavlefshmërinë e zgjedhjeve: Kodi Zgjedhor ka përcaktuar në mënyrë të detajuar cilat janë rastet kur zgjedhjet shpallen të pavlefshme, cili është organi kompetent dhe pasojat që sjell një vendim i tillë, sipas përcaktimeve të nenit 160 të Kodit Zgjedhor. Ndërsa në rast të marrjes së një vendimi për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një zonë zgjedhore, neni 161, pika 1 parashikon se KQZ-ja, eventualisht Kolegji Zgjedhor urdhëron përsëritjen e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore.
- f. Në rastin konkret, subjekti zgjedhor PD-AN ka parashtruar një numër të madh shkeljesh të Kushtetutës, Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Kodit të Praktikës së Mirë për Çështjet Zgjedhore dhe Kodit Zgjedhor, të cilat në tërësinë e tyre cënojnë rëndë procesin zgjedhor në një masë të tillë që ndikojnë drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve. Tërësia e këtyre shkeljeve krijon bindjen e plotë bazuar në fakte dhe prova të

*pakundërshtueshme, si dhe Kodin Zgjedhor, për shpalljen e pavlefshme dhe përsëritjen e zgjedhjeve në Zonën Zgjedhore Tiranë.*

- g. Mohimi i të drejtës për të votuar i emigrantëve: Deri në datën 19 prill 2021, nuk ka pasur asnjë ndalim që emigrantët shqiptarë, të hynin në Shqipëri dhe të vendoseshin në karantinë. Komiteti Teknik i Ekspertëve pranë Ministrisë së Shëndetësisë, vetëm 1 javë para zgjedhjeve, nxori një vendim që detyronte emigrantët që vinin nga Greqia apo Maqedonia e Veriut të karantinoheshin detyrimisht për një periudhë 2-javore. Ky vendim pengonte efektivisht 500 mijë emigrantë shqiptarë që jetojnë në Greqi dhe Maqedoni, për të ushtruar të drejtën e votës, në mënyrë diskriminuese.*
- h. Zgjedhësit, që ishin të infektuar me COVID-19 dhe që ndodheshin në karantinë, qenë të detyruar të respektonin rregullat e izolimit, duke u cënuar de facto e drejta e tyre për të votuar.*
- i. E drejta e çdo qytetari shqiptar për të votuar është e sanksionuar në nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, njëkohësisht është një nga të drejtat themelore e parashikuar në nenin 3, Protokollin 1 të KEDNj.*
- j. Ndërsa në neni 24 dhe 25 të Kodit Zgjedhor, është parashikuar shprehimisht e drejtën e votimit për emigrantët shqiptar në vendin e tyre të rezidencës, mundësi kjo e cila nuk u është dhënë, duke mohuar një nga të drejtat e tyre themelore.*
- k. Blerja e votës dhe përdorimi i personave me rekorde të tmerrshme kriminale:Në qarkun Tiranë është konstatuar shitblerja e votave dhe shkeljet e tjera flagrante. Ndërtimi i një skeme kriminale, e shtrirë në të gjithë Qarkun e Tiranës për blerjen e votës, nëpërmjet përfshirjes të personave me rekorde kriminale (88 prova), përbën shkelje flagrante të Kodit Zgjedhor, duke cënuar rëndë procesin zgjedhor, e për rrjedhojë duke ndikuar drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve.*
- l. Shitblerja e votës është një ndër problematikat kryesore të konstatuara edhe në Deklaratën e Gjetjeve dhe Rekomandimeve Paraprake të OSBE/ODIHR-it. Partia Demokratike nëpërmjet strukturave të saj në terren ka evidentuar dhe faktuar raste të shumta flagrante të shitblerjes së votës. Për të gjitha këto raste, PD ka depozituar 50 kallëzime penale në SPAK, ndër të cilat 30 kanë të bëjnë me raste masive të shitblerjes së votës dhe 130 kallëzime në prokuroritë e rretheve për shkelje të tjera. Në rastin e qarkut Tiranë, Partia Demokratike ka depozituar dy kallëzime në SPAK për rreth 100 zyrtarë të lartë të pushtetit qëndror dhe vendor, persona me rekorde të tmerrshme kriminale, persona nën kërkim, të përfshirë drejtpërdrejtë në blerjen e votave në favor të PS. Këta persona me rekorde kriminale, drejtohen nga drejtues të lartë të institucioneve shtetërore apo Partisë Socialiste.*
- m. Një ndër rastet me flagrant është kandidati për deputet O.R, caktuar në listën e PS me Nr. 30. Ky shtetas, 27-vjeçar, pa asnjë kontributi apo angazhim të mëparshëm në jetën, politike apo publike të vendit ia arriti të marrë 15.700 vota, duke lënë pas vetes figura të njohura të PS-së, si ish-zëvendëskryeministra, ministra, deputetë etj.*
- n. Kandidati për deputet T.N, caktuar në listën e subjektit zgjedhor PSD, ka angazhuar në Tiranë dy persona me rekorde të tmerrshme kriminale, të cilët nëpërmjet parave, por edhe kërcënimeve e dhunës, kanë tjetërsuar vullnetin e qytetarëve.*



- o. Janë evidentuar shitblerje votash me të mira materiale, dhënie e pagave shtese nga drejtuesi politik të PS për Qarkun Tiranë dhe njëkohësisht Drejtor i Përgjithshëm i OSHEE-së, ka dhënë një pagë shpërblim për 13 mijë punonjës të OSHEE-së, etj. Veprime këto të ndaluara nga neni 91 i Kodit Zgjedhor dhe neni 3 i Vendimit Nr. 9/2020 të KQZ-së.
- p. Blerja e votës nëpërmjet dhënies së bonuseve dhe përfitimeve të tjera: Shitblerja e votës u krye nëpërmjet dhënies së bonuseve dhe përfitimeve të tjera të cilat përbënin problem në procesin zgjedhor duke devijuar vullnetin e qytetarëve. Qeveria nëpërmjet akteve nënligjore ka miratuar Vendime Qeverie nëpërmjet të cilave është mundësuar dhënien e një shpërblimi në fundvit, për mjekët dhe punonjësit e Policisë së Shtetit. Është vendosur të ndryshohet struktura dhe niveli i pagave për punonjësit e stafit mjekësor, punonjësve të tjerë me arsim të lartë dhe punonjësit e stafit teknik të shkencave mjekësore në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë, Njesisë Mjekësore Ushtarake në Spitalin Universitar të Traumës, në strukturat e Forcave të Armatosura dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.
- q. Bashki të drejtuara nga kryebashkiakë të PS-së në Durrës, Tiranë, Kavajë, Lezhë, Rrogozhinë, Vorë, Krujë, Lac dhe Mirditë shpërndanë 40 milionë euro për familjet e prekura nga tërmeti i Nëntorit 2019. Kjo vlerë u nda përkatësisht në 14 milionë euro gjatë muajit Mars, ndërsa 26 milionë të tjera u shpërndanë në muaji Prill. Vetëm gjatë javës së fundit të fushatës zgjedhore, Bashkia Durrës shpërndau 6 milionë euro për procesin e rindërtimit ose 89 herë më shumë se sa ka shpërndarë në 15 muajt e fundit. Ndërsa, vlera konkrete dhe familjet përfituese në Qarkun Tiranë mbeten për t'u përcaktuar në momentin e marrjes së informacionit gjatë hetimit gjyqësor.
- r. Nuk është kryer një trajtim i barabartë në lidhje me familjet që përfitojnë nga fondi i rindërtimit. Janë kërcënuar bizneset për mbylljen e tyre. Është kryer transferimi i paligjshëm nëpër Zyrat e Gjendjes Civile më qëllim rritjen e zgjedhësve në zona të caktuara. Janë konstatuar dhënia e parave familjeve të prekura nga tërmeti; shpërndarja e ndihmave ushqimore nga eksponentët e PS; dhënie e ndihmave ushqimore në zonën e Kombinatit për komunitetin Romët, ndihma të kategorive në nevojë etj.
- s. Investimet publike/rindertimi: Shteti ka vendosur investimet publike në funksion të PS-së për zgjedhjet e 25 Prill 2021. Në vitin 2020, pra një vit para zgjedhjeve, pati një rritje të lartë të kontratave publike, qoftë në numër, ashtu edhe në vlerën e tyre. Janë prokuruar rreth 878 kontrata publike me vlerë 505 milionë Euro, ndërkohë që mesatarja e vlerës së kontratave publike të 5 viteve të fundit është në vlerën 116 milionë Euro.
- t. Neni 3 i Vendimit Nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator të KQZ-së, ndalon mbështetjen dhe promovimin, në periudhën 4-mujore para datës së zgjedhjeve, të projekteve ose investimeve, me interes apo shtrirje territoriale kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, të energjetikës, telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, në shërbim dhe interesit të publikut. Janë evidentuar së paku 20 raste në të gjithë vendin, Kryeministri, ministrat dhe deputetët promovuan projekte apo investime publike me qëllime të qarta elektorale. Nuk pati transparencë në prokurimet publike dhe koncesionet.

- u. Intimidimi i administratës shtetërore për të mbështetur PS: Gjatë fushatës u konstatuan raste të shumta të cilat janë denoncuar vazhdimisht nga PD, sesi të gjitha nivelet e administratës vendore dhe qendrore ishin përfshirë në fushatë duke mbështetur publikisht kandidatët e PS-së.
- v. Veç kësaj punësimi në sektorin publik u rrit ndjeshëm në periudhën parazgjedhore. Sipas INSTAT në 2020 punësimi në sektorin publik u rrit me 6% pra me 10.572 persona. Ndërkohë, më 24 Dhjetor, qeveria autorizoi edhe krijimin e 2.472 pozicione të reja në administratën publike. Qartësisht, punësimet në administratën publike në periudhën zgjedhore, kur nuk diktohen nga nevoja të ngutshme, kanë për qëllim të përkthehen në mbështetje dhe vota për partinë në pushtet.
- w. Vetëm në periudhën dhjetor 2020 — mars 2021, Bashkia Kamëz e çoi numrin e të punësuarve në 1.003 punonjës rishtazi. Pati denoncime se ministrja Belinda Balluku kishte ndërhyrë për të punësuar mbi 150 punonjës në drejtorinë e arkivit. Ndërkohë, ministrja e Shëndetësisë, Manastirliu, po aslitu kandidatë e PS, kërkonte me email që t'i dërgoheshin propozime për vendet vakante. Bashkia Rrogozhinë nga ana tjetër e rriti administratën e saj me 227 të punësuar rishtazi.
- x. Subjekti Zgjedhor PD –AN-ja në argumentet e saj i është referuar dhe statistikave të publikuar nga Ministria e Financës.
- y. Këto veprime janë shkelje të rënda ligjore, të cilat kanë si qëllim përfitim politik duke devijuar vullnetin e votuesve. Konstatimet e sipërcituara janë evidentuar edhe në Raportin Paraprak të OSBE/ODIHR.
- z. Dhënia e lejeve të legalizimit/ndërtimit gjatë fushatës zgjedhore: Deputetë të ndryshëm të Partisë Socialiste kanë shpërndarë leje legalizimi në kundërshtim me përcaktimin e Kodit Zgjedhor dhe Vendimit Nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator të KQZ-së. Kjo kategori, nuk e ka në kompetencë të shpërndajnë një dokument të tillë nga zyra e ASHK-së. Këto veprime qartazi tregojnë se si Partia Socialiste e ka vendosur shtetin në dispozicion të qëllimeve të saj elektorale. Në raste të përsëritura, për të cilat Partia Demokratike disponon foto dhe video, ku kandidatë për deputetë shpërndanë leje legalizimi në periudhën e ndaluar nga Kodi Zgjedhor, me qëllim të pastër elektorale. Në 20 Prill, u publikua një audiopërgjim i drejtorit të përgjithshëm të Kadastrës, gjatë një takimi me vartësit e tij, ky i fundit u kërkoi “...që mos procedojnë më tej me rreth 100.000 kërkesa për leje legalizimi të banesave private, të cilat me siguri do të refuzohen duke sjellë prishjen e tyre. Kjo pasi, refuzimi i dhënies së lejeve të legalizimit do të sillte që këta persona të votonin për opozitën.
- aa. Sa më lart, paditësi PD –AN, konkludon se, është e qartë se parimi i barazisë ndërmjet palëve garuese në zgjedhje u çënuar rëndë pasi Shteti dhe Partia në pushtet (PS) u shkrinë në një. Një konstatim i tillë gjendet dhe në Raportin Paraprak të OSBE/ODIHR). Ky përdorim masiv i burimeve shtetërore, përveçse një veprimtari e paligjshme, e cila duhet hetuar dhe dënuar nga organet e drejtësisë, është në shkelje flagrante të neneve 78, 91, 92 të Kodit Zgjedhor dhe neneve 3 dhe 6 të Vendimit Nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator të KQZ-së, çka ka çënuar rëndë procesin zgjedhor, duke ndikuar

*drejtpërdrejtë në vullnetin e zgjedhësve, rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve dhe ndarjen e mandateve në Qarkun e Durrës.*

- bb. Përdorimi i paligjshëm i të dhënave personale: Shteti vendosi të dhënat personal në dispozicion të serverave të PS në Tiranë dhe Durrës. Në datën 11 prill, media publikoi një bazë të dhënash të 910.000 zgjedhësve që përdorte Partia Socialiste në Tiranë, duke bërë publike të dhëna personale si numri i ID, vendi i banimit, numri i telefonit dhe bindja politike e shprehur në zgjedhjet e kaluara dhe projeksionet për zgjedhjet e 2021; këto të dhëna janë marrë nga të dhëna shtetërore që qytetarët i kanë vënë në dispozicion në portalin e-albania për të marrë shërbime gjatë pandemisë, apo në institucione të tjera shtetërore për të marrë shërbime nga administrata. Gjithashtu sipas denoncimeve të LSI, faktohet të ketë ekzistuar një databas e ngjashme në Durrës, në të cilë kishte të dhënat personale për më shumë se 350 mijë zgjedhës, me emër/mbiemër, nr. ID, nr. telefoni, vendbanimi, etj. Rrjedhja e të dhënave personale sensitive, duke përfshirë edhe preferencat politike të zgjedhësve përbën shqetësim serioz dhe i bën zgjedhësit vulnerabil. Skandali me të dhënat personale u evidentua edhe në Raportin Paraprak të OSBE/ODIHR.*
- cc. Mbledhja, përpunimi, përdorimi dhe publikimi i të dhënave personale pa pasur miratimin me shkrim të mbajtësit të të dhënave është shkelje e rëndë e nenit 35 të Kushtetutës së Shqipërisë, nenit 8 të Konventës Evropiane dhe neneve 6 dhe 7 të ligjit “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.*
- dd. Duke qenë se Shteti dhe Partia ishin të pajisur me informacion për secilin zgjedhës, përfshirë edhe bindjet e tyre politike, kjo i bëri më vulnerabël përballë pushtetit dhe më lehtësisht viktimë e presioneve apo mjeteve të tjera të kundërligjshme për të ndaluar të shprehin vullnetin e tyre lirisht, duke përdorur mekanizma të ndryshëm pengues.*
- ee. Ndryshimet e njëanshme të Kodit Zgjedhor: Në datën 30.07.2020, Kuvendi i Shqipërisë nëpërmjet ligjit 115/2020, miratoi nismën e PS-së për disa ndryshime kushtetuese të cilat në thelb sanksiononin: (i) heqjen e koalicioneve parazgjedhore; (ii) sistemin me votim preferencial për 2/3 e kandidatëve; dhe (iii) vendosjen e një pragu kombëtar. Në vijim të ndryshimeve kushtetuese, Kuvendi i Shqipërisë miratoi në datën 05.10.2020 disa ndryshime në Kodin Zgjedhor, të cilat kishin të bënin me: (i) ulja nga 3% në 1% e pragut kombëtar; (ii) renditja e kandidatëve që përfitojnë mandat ndryshon nëse kandidati ka marrë një numër votash parapëlqyese më të madh se herësi që del nga pjesëtimi i numrit të votave të subjektit me numrin e mandateve të fituara; (iii) ri-renditjen e listës fituese sipas kandidatëve që kanë fituar numër votash më të madh se herësi; dhe (iv) kryetari i partisë ka të drejtë të kandidojë deri në katër qarqe.*
- ff. Ndryshimet e njëanshme të Kodit Zgjedhor nga Partia Socialiste, duke shkelur marrëveshjen konsensuale me KQZ-në u evidentuan si problematika edhe nga Misioni i OSBE/ODIHR.*
- gg. Numri i madh i fletëve të votimit të pavlefshme: Numri i votave të pavlefshme në të gjithë vendin ishte 83.026, ose 5% e numrit total të votuesve dhe vetëm për Qarkun e Tiranës ishin 18.399 vota të pavlefshme ose 3.80 % ky fakt është ndikuar nga përmbajtja e fletës*

së votimit me numra dhe jo me emrat e kandidatëve, duke krijuar konfuzion ditën e zgjedhjeve.

- hh. *Miratimi i një flete votimi në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga neni 98 i Kodit Zgjedhor dhe pika 27 e Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, solli një numër tejet të lart të fletëve të votimit, të cilat nëse do të ishin përkthyer në mandate mund të ndryshonin rezultatin nga 5 – 8 mandate në të gjithë Shqipërinë. Këto mandate mund të sillnin jo vetëm ndryshimin e rezultatit në qarqe të caktuara, ku diferenca ndërmjet palëve është e ngushtë, por edhe në rang kombëtar, kur dihet se partia e parë sipas rezultateve paraprake ka vetëm katër mandate më shumë se shumica e kërkuar për formimin e qeverisë.*
- ii. *Diskriminimi i kandidatëve gjatë procesit zgjedhor: Ligji u lejon vetëm Kryetarëve të partive, por asnjë kandidat tjetër që të kandidojë deri në 4 zona zgjedhore, ndërkohë që kandidatët e tjerë mund të kandidojnë vetëm në një zonë, gjë që përbën shkelje të së drejtës së kandidimit në kushte të barabarta, ky fakt, përbën një diskriminim në të drejtën për t'u zgjedhur, në kuptim të neneve 18 dhe 45 të Kushtetutës.*
- jj. *Votimi më shumë se një herë, votimi për të tretët apo votimi familjar: Një nga risitë e zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë në 25 prill 2021 ishte identifikimi elektronik i zgjedhësve. Futja e këtij mekanizmi të ri në Kodin Zgjedhor ishte kërkuar me forcë nga PD dhe kishte qenë pjesë e konsensusit të arritur ndërmjet palëve për ndryshimet e Kodit Zgjedhor në Korrik 2020. Nëpërmjet identifikimit elektronik synohej të eliminohej votimi më shumë se një herë, në të njëjtën qendër votimi apo qendra të tjera, votimi për të tretët apo votimi familjar. Por, gjithsesi ajo që mbetet problematike është fakti se nga informacionet e marra në terren nga strukturat e Partisë Demokratike rezultoi se këto fenomene nuk janë shmangur.*
- kk. *Nga subjekti zgjedhor PD –AN jepen detaje mbi rastet konkrete. Është konstatuar se persona të ndryshëm kanë votuar më shumë se një herë, qoftë për të tretët apo familjarë të tyre, duke shkelur kështu drejtpërdrejtë Kodin Zgjedhor. Nga ana tjetër, ekzistenca e këtij problemi u pranua edhe nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili në datën 6 maj njoftoi fillimin e procesit të kryqëzimit të dhënave për të konstatuar rastet e votimit më shumë se një herë në një qendër votimi apo qendra të ndryshme.*
- ll. *Nga të dhënat e administruara nga KAS, nga kryqëzimi i të dhënave të pajisjeve PEI, rezulton se shenjat e gishtërinjve të 51 personave janë përdorur për identifikimin e 123 zgjedhësve. Bazuar mbi këtë fakt këta 51 persona kanë votuar 123 herë ose rreth 2.4 herë secili.*
- mm. *Si përfundim, subjekti zgjedhor PD – AN-ja, vlerëson se, në tërësinë e tyre këto shkelje të ligjit shqiptar dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, cënuan rëndë procesin zgjedhor, duke ndikuar drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve. Në këto kushte, është e qartë se vendimet e marra në kundërshtim me nenin 98 të Kodit Zgjedhor dhe pikat 27 dhe 49 të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, cënuan rëndë procesin zgjedhor, duke diktuar një rezultat në shpërputhje me vullnetin e zgjedhësve, e për rrjedhojë edhe ndarjen e mandateve, dhe për rrjedhojë në kuptim të nenit 160 të*

*Kodit Zgjedhor, ky proces zgjedhor në Qarkun Tiranë duhet të shpallet i pavlefshëm dhe të urdhërohet përsëritja e zgjedhjeve në këtë qark.*

- nn. Në tërësinë e tyre këto shkelje flagrante të ligjit – shitblerja e votës, përdorimi i personave me precedentë kriminalë, përdorimi i paligjshëm i administratës, vjedhja dhe përdorimi kriminal i të dhënave personale të shtetasve nga PS, përdorimi i paligjshëm, masiv dhe sistematik i parave të buxhetit të shtetit për tjetërsimin e vullnetit të qytetarëve dhe përdorimi i lejeve të legalizimit për vota – cënuan rëndë procesin zgjedhor, duke ndikuar drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore Qarku Tiranë. Këto shkelje dhe pasojat e tyre përmbushin kriteret e kërkuara nga nenet 160 dhe 161 të Kodit Zgjedhor për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve dhe përsëritjen e zgjedhjeve në Qarkun e Tiranës.*
- oo. Me qëllim garantimin e të drejtës së palës ankuese për një proces të rregullt ligjor, PD-AN parashtron kërkesat e saj për marrjen e provave pranë organeve të administratës publike, në përputhje me nenet 136 dhe 137 të Kodit Zgjedhor, dhe nenet 223 dhe 224 të Kodit të Procedurës Civile.*
- pp. Bazuar në nenin 42 të Kushtetutës së Shqipërisë, nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, pikat 27 dhe 49 të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore dhe nenet 158, 160 dhe 161 të Kodit Zgjedhor, përfundimisht, kërkohet: “Pranimi i padisë për shfuqizimin e vendimit nr. 91, datë 27.05.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS), për rrëzimin e kërkesës ankimore Nr. 39 të subjektit zgjedhor Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim (PD-AN). Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara në datën 25.04.2021 në zonën zgjedhore Qarku Tiranë. Urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Tiranë.”.*

**15. Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,** nëpërmjet përfaqësuesve të tij, gjatë gjykimit pretenduan se:

- *Vendimi nr. Nr. 91, datë 27.05.2021 i KAS, është i bazuara në ligj dhe në prova dhe si i tillë, duhet të lihet në fuqi.*

**16. Personi i Interesuar, Partia Socialiste e Shqipërisë,** gjatë gjykimit, nëpërmjet përfaqësuesve të tij, pretendoi se:

- a. Paditë e ngritura kundër vendimit të KAS-it Nr. 91, datë 27.05.2021 janë të pabazuara në ligj dhe në prova dhe duhet të rrëzohen nga Kolegji. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve ka vlerësuar drejt dhe saktë të gjitha pretendimet duke interpretuar me përpikmëri ligjin zgjedhor për mbi pavlefshmërinë e zgjedhjeve dhe përsëritjen e tyre.*
- b. Neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si tipar kryesor për shkeljet e ligjit, me qëllim që ato të trajtohen si shkak për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, peshën e tyre dëmprurëse mbi zgjedhjet. Në këto raste dëmi mund të vijë edhe nga një shkelje e vetme, por tronditëse për zgjedhësit ose rregullshmërinë e procesit. Përgjatë zgjedhjeve mund të ndodhin parregullsi apo shkelje të shumta, të lehta ose të rënda, të cilat mund të kenë lidhje me aspekte të veçanta të procesit, por jo të gjitha mund të cilësohen “shkelje që cënojnë*

rëndë procesin zgjedhor”. Shkelje që çenojnë rëndë procesin zgjedhor janë vetëm shkeljet që ose i pengojnë/largojnë zgjedhësit në masë nga votimi, ose që i detyrojnë ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që tjetërsojnë në masë votën e hedhur.

- c. Në interpretim të nenit 125/4 dhe 160 të Kodit Zgjedhor, në çdo rast kërkesa për pavlefshmëri duhet të përmbajë të nominuar qendrën apo qendrat e votimit për të cilat kërkohet pavlefshmëria e rezultatit zgjedhor të miratuar. Secila qendër votimi ka specifikat e veta apo shkaqe të ndryshme, të veçanta ose të përbashkëta për konstatimin e elementëve të pavlefshmërisë së zgjedhjeve dhe kjo gjithmonë në varësi të bazës faktike të pretendimit të parashtruar nga paditësat. Edhe nga përmbajtja e padive nuk rezulton që të jenë dhënë sqarime apo interpretime sipas të cilave kërkohet pavlefshmëria e rezultatit në një apo disa qendra votimi.
- d. Nga ana e subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë janë pretenduar fakte që lidhen me shitblerjen e votës, mohim të se drejtës për të votuar, raste të votimit të shumëfishtë, raste punësimi, dhënie ndihmash etj, por asnjëherë të provuara se sa kanë ndikuar në pengimin/largimin e zgjedhësve nga votimi, në detyrimin e votuesve që të votojnë në një mënyrë të caktuar, apo tjetërsimin e votës.
- e. Pala paditëse duhet të provojë qartësisht se ka pasur shkelje të ligjit, të cilat kanë ndodhur në qendrat e votimit dhe se ekziston lidhja shkakesore ndermjet shkeljes së ligjit dhe pasojës, pra cënimit të rëndë procesin zgjedhor.
- f. Në asnjë moment nuk pretendohet pavlefshmëri në një apo disa qendra votimi konkrete të qarkut të Tiranë, pasi pretendimet e ngritura nga paditësi janë të përgjithshme.
- g. Po ashtu ky subjekt ka pretenduar shkelje të ligjit zgjedhor që lidhen me ushtrimin e veprimtarive të ndaluara si miratimi i V.K.M-ve apo ndryshimeve të V.K.M-ve, por që nuk janë ankimuar asnjëherë prej tij në KQZ-ë.
- h. Përcaktimi i Urdhrit nr. 219, datë 19.04.2021 i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia" si një "vendim që pengoi efektivisht 500 mijë emigrantë shqiptarë që jetojnë në Greqi për të ushtruar të drejtën e votës". Ky urdhër është kontestuar pa sukses në rrugë ligjore në gjykatën administrative të shkallës së parë Tiranë dhe në gjykatën administrative të Apelit nga subjekti ankues LSI. Subjekti ankues PD nuk ka shfrytëzuar mjetet ligjore për kontestimin e tij. Për këtë arsye, ligjshmëria e urdhrit nuk mund të vihet në diskutim. Efektet e një urdhri të ligjshëm nuk mund të formojnë shkelje. Pa shkelje nuk ka pavlefshmëri.
- i. Lidhur me pretendimin tjetër se në ditën e zgjedhjeve, sipas Ministrisë së Shëndetësisë, numri i personave të infektuar me COVID-19 ishte rreth 23.000 Statistika e ofruar nuk saktëson se sa prej tyre janë qytetarë të qarkut të Tiranës, e as faktin se sa prej tyre kanë qenë zgjedhës.
- j. Një pretendim i veçantë ka lidhje me numrin anomalisht të lartë të fletëve të votimit të pavlefshme. Në zonën zgjedhore Qarku Tiranës numri i këtyre votave është 18399 ose 3.79% e numrit total të votave, por ky numër nuk mund të konsiderohet anomalisht i lartë, sepse mungon baza krahasuese, fakt ky i konstatuar drejt nga KAS.

- k. Në tërësinë e tyre, të gjitha faktet apo ngjarjet e pretenduar prej paditësave përveçse janë të paprovueshme për kundërligjshmërinë e tyre, nuk referojnë në të paktën një qendër votimi qarkun e Tiranë dhe nuk parashtrohet asnjë arsytim i detajuar sipas kërkesave të ligjit. Ky është tregues i padiskutueshëm se shkaqet e pretenduara nuk janë gjë tjetër vecse parashtrime formale pa asnjë thelb të njohur nga ligji zgjedhor.
- l. Edhe sikur të kishite patur shkelje ligji, këto shkelje duhet që të kenë ndodhur në qendrën e votimit dhe jo në vende të tjera, si edhe të kenë ndikuar në shpërndarjen e mandateve.
- m. Sipas nenit 160, pika 4 të K.Z parashikohet se "Shqyrtimi i kërkesave bëhet sipas procedurave të percaktuara në pjesën X të këtij Kodi. KQZ-ja, në marrjen e vendimit për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, mund konsultohet me KZAZ-në përkatëse". Nga kjo dispozitë kuptojmë se shklejet, përveçse, duhet të kenë ndodhur në ambientet e qendrës së votimit, duhet që të jetë mbajtur edhe një raport nga K.Z.A.Z-të ose informacioni t'i jetë referuar KZAZ-ve me shkrim nga qendra e votimit.
- n. Në lidhje me pretendimet e ngritur nga kandidati i pavarur Boiken Abazi, gjatë gjykimit është mbajtur i njëjti qëndrim sikurse ka disponuar KAS-i. Në rastin e pengimit të vëzhguesve të tij kjo sjell parregullsi, por jo pavlefshmëri të zgjedhjeve, për sa kohë që filtrat dhe garancitë e tjera kanë funksionuar. Gjithashtu tabela zgjedhore është vetëm për subjektet zgjedhore parti ose koalicione dhe jo për kandidat të pavarur.
- o. Pamundësinë për të lexuar nga materialet e videove nuk tregojnë tjetërsim në masë të rezultatit të zgjedhjeve, që do të ishte kusht për pavlefshmëri, pamjet filimike nuk kanë vlerë provuese dhe se pretendimi se 164 fletë votimi janë të pavlefshme në dëm të tij është i pa shoqëruar me prova;
- p. Për sa kohë, në asnjë moment nuk provohet sipas ligjit pavlefshmëria e zgjedhjeve në qendrën e votimit, edhe kërkimi tjetër për përsëritjen e tyre sipas nenit 161 të Kodit Zgjedhor mbetet i pa bazuar në ligj dhe në prova.

17. **Personi i Interesuar, Lëvizja Socialiste për Integrim**, ka qënë në mungesë gjatë gjykimit të kësaj çështje, dhe rezultoi se u tregua indiferente për të paraqitur pretendime me shkrim. Në këto kushte, Kolegji, me vendimmarrje të ndërmjetme vendosi të vijojë shqyrtimin e padive të paraqitura përpara tij në mungesë të kësaj pale ndërgjyqëse.

#### **IV. Arsytimi i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor:**

18. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor pasi analizoi dispozitat ligjore, administroi provat shkresore dhe dëgjoi pretendimet e palëve, çmon se Palët paditëse, subjektet zgjedhore kandidati i propozuar nga zgjedhësit z.Boiken Abazi dhe **"Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN),"** kanë parashtruar argumentet e tyre lidhur me kërkesën për pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në datë 25.04.2021 në Republikën e Shqipërisë, për qarkun Tiranë. Në kushtet kur palët paditëse kanë ankimuar në rrugë gjyqësore vendimmarrjen e KAS-it, dhe në tërësi kanë pretendime specifike dhe gjithashtu të përbashkëta, ky Kolegj vlerësoi të arsyetojë sa më poshtë:

19. Neni 3 i Protokollit nr. 1 “E drejta për zgjedhje të lira” (në vijim Neni 3 Protokollit nr. 1), parashikon se: *“Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë, në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës.”* Sipas Konventës, ruajtja e lirive themelore “mbështetet kryesisht mbi një regjim politik me të vërtetë demokratik. Shtetet gëzojnë pra një hapësirë të gjerë vlerësimi në mënyrën e organizimit të votimit.

20. Neni 45 (Ndryshuar paragrafi i tretë me ligjin nr.137/2015, datë 17.12.2015) Kreu III “Liritë Dhe Të Drejtat Politike i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë” parashikon se: *“1. Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet. 2. Përrjashtohen nga e drejta e zgjedhjes shtetasit e deklaruar me vendim gjyqësor të formës së prerë si të paaftë mendërisht. 3. Përrjashtohen nga e drejta për t’u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim, me vendim përrfundimtar të formës së prerë, për kryerjen e një krimi, sipas rregullave të përrcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në raste përrjashtimore dhe të justifikuara, ligji mund të parashikojë kufizime të së drejtës për të zgjedhur të shtetasve që vuajnë dënimin me heqje lirie, ose të së drejtës për t’u zgjedhur para dhënies së një vendimi përrfundimtar apo kur shtetasit janë dëbuar për një krim ose për cenim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike. 4. Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë”.*

21. Nisur nga sa më sipër, në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë apo në aktet nënligjore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, apo/ose Komisionit Rregullator janë parashikuar rregulla për përrgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikqyrjen dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve (neni 1 para. 1). Përrmes këtyre rregullimeve ligjore garantoher parashikimi kushtetues për të siguruar zgjedhje të lira dhe të barabarta (neni 1, para. 3 i Kushtetutës), si dhe votë të lirë, fshehtë dhe barabartë për qytetarët (neni 45, para. 4 i Kushtetutës). Zgjedhjet janë një gur themeli i demokracisë të një vendi dhe zhvillimi i zgjedhjeve të lira, forcon parimin e shtetit të së drejtës dhe i jep jetë sundimit të ligjit. Nga ana tjetër, veprimet në kundërshtim me ligjin apo akteve nënligjore (specifike apo me karakter të përrgjithshëm), passjellin një administrim të dobët të procesit zgjedhor, dhe kanë një ndikim afatgjatë tek liritë dhe të drejtat e njeriut.

22. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se periudha para zgjedhore, dita e votimit dhe periudha pas procesit zgjedhor, *(dhe jo vetëm)* duhet të karakterizohet nga ligjshmëria, vendosmëria dhe transparenca, për të garantuar të drejtat demokratike në një vend të caktuar. Rregullat e parashikuara nga ligjet apo akteve nënligjore, që rregullojnë fushatën zgjedhore dhe periudhën parazgjedhjeve, si qëllim kryesor kanë një garë të barabartë dhe të drejtë, dhe pengimin e epërrsisë që mund të ketë subjekti politik që është në qeverisje, ndërkohë që përrcaktimet ligjore të ditës së zgjedhjeve dhe periudhës pas votimit, si qëllim kryesor kanë garantimin e shprehjes së vullnetit nëpërrmjet *votës vetjake, të barabartë, të lirë dhe të fshehtë*.

23. Në kuadër të garantimit të së drejtës së votës, zgjedhjeve të lira dhe të barabarta, si dhe papërrkshëmërisë së procesit zgjedhor, ligjvënësi në Kodin Zgjedhor, ka përrcaktuar rastet e shpalljes së pavlefshmërisë së zgjedhjeve.



24. Konkretisht, neni 160 Kodi Zgjedhor parashikon ndër të tjera se: “1. KQZ-ja kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhorë, i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një apo më shumë qendra votimi, në rast se:

- a) Kanë ndodhur shkelje të ligjit, të cilat kanë çënuar rëndë procesin zgjedhor ose kur tërësia e shkeljeve të ligjit, sipas kësaj shkronje, të ndodhura në ato qendra votimi mund të ketë çënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore;
- b) Kanë ndodhur fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhesve në votim; ose
- c) Votimi nuk ka filluar apo është pezulluar për më shumë se pesë orë....

3. Kërkësa për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve duhet të përmbajë shkaqet ligjore përshkrimin e rasteve të shkejeve dhe arsyetimin e detajuar për pasojën...”

25. Sipas parashikimit të mësipërm ligjor, Kolegji vlerëson se duke qënë një rast përjashtimor, në thelb kërkohet të nënvizohet parimi i rëndësishëm i “**paprekshmërisë së procesit zgjedhor**”, parim nga i cili nuk mund të ketë përjashtim edhe Kolegji Zgjedhor Gjyqësor. Procesi i vendimmarrjes lidhur me pazgjedhshmërinë ose me kundërshtimin e rezultateve zgjedhore duhet të jetë brenda kornizës së një minimumi garancish kundër arbitraritetit. Vendimet për shpallje të një votimi si të pavlefshëm duhet t’i përgjigjen një pamundësie reale për të përcaktuar dëshirat e zgjedhësve (*Vendimi i GJEDNJ-së Kovach k. Ukrainës nr. 39424/02, GjEDNJ 2008*).

25.1 Në çështjen Kerimova k. Azerbajxhanit, nr. 20799/06, 30 shtator 2010, Gjykata e GJEDNJ-së arriti në përfundimin/konkluzionin se, falsifikimet e kryera nga dy zyrtarë zgjedhorë nuk kishin arritur ta shtrembëronin rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, të fituara nga paditësja. Pavarësisht sipas Gjykatës, autoritetet kombëtare i kishin shpallur të pavlefshme rezultatet, në shkelje të së drejtës së brendshme zgjedhore dhe pa marrë parasysh përmasat e vogla të efekteve të falsifikimeve të lartpërmendura. .... Ato i kanë çënuar në mënyrë arbitrare të drejtat zgjedhore të paditëses duke e penguar atë të marrë funksionet parlamentare. Gjykata doli andej në konkluzionin e rëndësishëm se, kjo shpallje pavlefshmërie tregonte një mungesë konsiderate për paprekshmërinë e procesit zgjedhor, e cila nuk mund të pajtohej me frymën e së drejtës për zgjedhje të lira. *Në fakt, roli i gjykatave nuk është kurrësi që të ndryshojnë shprehjen e popullit.*

26. Në vijim të këtij arsjetimi, subjektet zgjedhore gëzojnë të drejtë për të kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve, në një ose më shumë qendra votimi, në raste përjashtimore, dhe vetëm në ato raste kur është çënuar procesi zgjedhor, shprehja e lirë e votës, duke paraqitur shkaqet ligjore, përshkrimin e rasteve të shkeljeve të vëna re para procesit zgjedhor që kanë penguar procesin, shkeljeve të vëna re gjatë ditës së votimit apo shkeljeve të konstatuara në procesin e administrimit dhe numërimit të votave, në lidhje me votimin dhe arsjetimin e detajuar për pasojën e tyre (*ndikimin real në rezultat*).

27. Kolegji vë në dukje se në interpretim të nenit 160 paragrafi 1 gërma “a” të Kodit Zgjedhor, në rastet e kërkesës për shpallje të pavlefshme të zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimi, vlerësimi i “shkeljes” duhet të bërë nisur nga kritere objektive. Subjekti/et zgjedhor/e ankues/e **a)** duhet të evidentojnë veprimet apo mosveprimet, të cilat pretendohen si shkelje të ligjit që kanë ndodhur para ose gjatë ditës së votimit, që kanë lidhje me lirinë e

shprehjes së votës, shprehjes së vullnetit të votuesve; **b**) kanë barrën e provës që të provojë ekzistencën e shkeljeve të pretenduara; si dhe **c**) duhet të provojnë lidhjen shkakësore midis shkeljes së pretenduar dhe pasojës, cënimit të rëndë të procesit zgjedhor.

28. Kolegji thekson se nuk ka rëndësi nëse “shkeljet” janë një ose më shumë, por me rëndësi është që të provohet se “shkelja” apo “shkeljet” të jenë të një shkalle të tillë që kanë vënë në rrezik dhe kanë cenuar zhvillimin e procesit zgjedhor sipas parimeve kushtetuese dhe atyre ligjore. Në këtë kuptim, subjektet zgjedhorë ankues duhet të provojnë qartazi shkeljen apo shkeljet ligjore në procesin zgjedhor, si dhe lidhjen shkakësore të drejtëpërdrejtë midis shkeljes apo shkeljeve dhe cënimit të rëndë të procesit zgjedhor. Pikërisht, evidentimi i shkeljes apo shkeljeve konkrete, argumentimi i lidhjes shkakësore midis shkeljes apo shkeljeve dhe cënimit të procesit zgjedhor, do të mund të krijonte bindjen mbi bazueshmërinë e kërimit për pavlefshmëri të zgjedhjeve në një ose më shumë qendra votimi dhe njëkohësisht do të respektonte parimin e “paprekshmërisë së procesit zgjedhor”, pasi në fakt, roli i gjykatave nuk është kurrsesi që të ndryshojnë shprehjen e popullit.

29. Në gërmën “b” të paragrafit të parë, të nenit 160 është parashikuar si shkak për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një apo disa qendra votimi, rasti i ndodhjes së fatkeqësisë natyrore, që duhet të jetë në përmasa të tilla që pengon pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim. Ligji nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, në nenin 3 parashikon se “*Fatkeqësi natyrore*” janë fatkeqësitë që shkaktohen nga dukuri natyrore ekstreme, që lidhen me tërmetet, përmbytjet dhe vërshimet e ujit, temperaturat ekstreme dhe të tejzgjatura, rrëshqitjet arkitektonike, ortekët, erërat e forta në tokë dhe në det, zjarret masive në pyje, sëmundjet infektive masive dhe dukuri të tjera që ndikojnë në jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin”. Në nenin 4 të ligjit përcaktohet se: “1. Çdo person ka të drejtën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. 2. Në rastet e fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera, mbrojtja dhe shpëtimi i jetës së njerëzve kanë prioritet mbi çdo aktivitet tjetër të mbrojtjes civile”.

30. Me VKM nr. 243, datë 24.03.2020 është shpallur e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19. Kolegji thekson se sipas parashikimit ligjor të neni 160 të Kodit Zgjedhor gjendja e fatkeqësisë natyrore duhet të jetë e atyre përmasave, që të pengojnë pjesëmarrjen e zgjedhësve në votime. Kolegji vlerëson se kriza e shëndetit publik e shkaktuar nga “COVID-19” në vitin 2020, ka shkaktuar dëme të mëdha ekonomike dhe shëndetësore madje dhe të humbjes së jetëve njerëzore. Gjatë vitit të kaluar 2020 dhe në vijim, u evidentua qartazi se jo vetëm vendet në zhvillim, por edhe vendet e zhvilluara dhe me demokraci të konsoliduar u gjendën përballë vështirësive të mëdha në situatën e krijuar nga pandemia e “COVID-19”. Në këtë situatë synimi kryesor është mbrojtja e jetës dhe shëndetit të qytetarëve. Por nga ana tjetër, kjo periudhë e vështirë ka përballur shtetet dhe shoqëritë me sfida të tjera, që janë thelbësore për të garantuar demokracinë. Një nga këto sfida është dhe organizimi dhe zhvillimi i procesve zgjedhore, siç janë dhe zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë datë 25 Prill 2021. Në këtë kuptim institucionet shtetërore, publike, subjektet zgjedhorë, shoqëria civile në kuadër të zhvillimit të zgjedhjeve në periudhën e pandemisë Covid-19, duhet të veprojnë dhe bashkëpunojnë me qëllim që të garantojnë mbrojtjen

e të drejtave themelore kushtetuese dhe më e rëndësishme, të drejtën e jetës dhe shëndetit të individit.

31. Kolegji vë në dukje se neni 160 para.1 i Kodit Zgjedhor në pikat “b” dhe “c” parashkon raste të pavlefshmërisë së një apo më shumë qendra votimi që lidhen ekskluzivisht me pjesëmarrjen në votim dhe procedurën e votimit. Konkretisht, mosfillimi i votimit apo pezullimi i tij për më shumë se pesë orë, është rasti i parashikuar nga gërma “c” që mjafton të provohet që ka ndodhur dhe i bën zgjedhjet në një apo disa qendra votimi të pavlefshme, pa u lidhur me ekzistencën e ndonjë pasoje tjetër.

32. Paragrafi i tretë i nenit 160 të Kodit Zgjedhor, përcakton se subjekti zgjedhorë që pretendon për pavlefshmëri të zgjedhjeve, duhet të paraqesë kërkesën e cila duhet të përmbajë shkaqet reale dhe ligjore për përshkrimin e rasteve të shkeljeve të ndodhura gjatë ditës së votimit apo pas saj dhe arsyetimin e detajuar për pasojën e tyre.

33. Ndërkohë siç është trajtuar më lart, rasti i pavlefshmërisë së zgjedhjeve në një apo disa qendra votimi i parashikuar nga neni 160 para.1, gërma “a” i Kodit Zgjedhor i referohet si shkeljeve të pretenduara gjatë situatës parazgjedhore dhe/ose gjatë zhvillimit të procesit të zgjedhjeve, me kusht që; *i*) të kenë çenuar rëndë procesin zgjedhor dhe; *ii*) të kenë ndikuar në ndarjen e mandateve duke mos u konsideruar kështu të lira.

34. Kolegji thekson se shkeljet që të sjellin shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në një apo disa qendra votimi, duhet të jenë të asaj shkalle, që shkaktojnë pamundësinë reale për të përcaktuar dëshirën dhe vullnetin e zgjedhësve. Kolegji vlerëson se evidentimi dhe provueshmëria e një shkelje apo shkeljeve të caktuara, duhet të pasohet nga vërtetimi i faktit që nga shkelja e kryer, ishte penguar apo tjetërsuar vullneti i zgjedhësve dhe rrjedhimisht ishte ndryshuar rezultati i zgjedhjeve. Kolegji vlerëson se e rëndësishme është ruajtja e ligjshmërisë së procesit zgjedhor dhe garantimi i votës së lirë. Për pasojë, shpallja e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në një ose disa qendra zgjedhore mund të bëhet për arsye shkeljeve të rënda të ligjit.

35. Në këtë drejtim Kolegji gjen të drejtë arsyetimin e bërë nga KAS-i, sipas të cilit *“Shkelje që çënojnë rëndë procesin zgjedhor janë vetëm shkeljet që i pengojnë/largojnë zgjedhësit në masë nga votimi ose që i detyrojnë ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që tjetërsojnë në masë votën e hedhur”*.

36. Kodi Zgjedhor ka përcaktuar një kategori shkeljesh, të cilat çënojnë procesin zgjedhor dhe që përbëjnë kundravajtje administrative. Konkretisht, në pjesën XIII të Kodit Zgjedhor “Përgjegjësitë dhe sanksionet” përmendim, Përgjegjësia e personave të ngarkuar me administrimin e zgjedhjeve (neni 168), Mosbashkëpunimi me KQZ-në (neni 169), Sanksionet administrative (neni 170), Sanksionet për subjektin zgjedhor për shkelje të ndalimeve të këtij ligji (neni 172), Sanksionet në lidhje me financimin e fushatës (neni 73), Thyerja e heshtjes zgjedhore (neni 174), Sanksioni për mosrespektim të barazisë gjinore (neni 175), Ekzekutimi i sanksioneve administrative (neni 176), përcaktohen rastet konkrete të shkeljeve dhe masat që merren në lidhje me to. Rezulton se në asnjë rast kodi nuk ka parashikuar si pasojë të tyre pavlefshmërinë apo përsëritjen e zgjedhjeve.

37. Kolegji thekson se shkeljet që janë kryer dhe që kanë çenuar rëndë procesin zgjedhor, sipas pretendimeve të paraqitura në gjykim nga palët paditëse, duhet të bazohen në prova, vlerësimi i të cilave do të kryhet përmes një gjykimit të drejtë dhe të arsyeshëm. Nga ana tjetër

sipas nenit 11 të K.Pr.C dhe nenit 136 të Kodit Zgjedhor palët paditëse kanë detyrimin të provojnë prenimet e tyre. Subjektet zgjedhore në kupim të nenit 136 të Kodit Zgjedhor kanë të drejtë të kërkojnë marrjen e provave, nëse provojnë që nuk është bërë e mundur sigurimi i tyre nga vetë subjekti pretendues, duke treguar edhe shkaqet përkatëse. Neni 136 parashikon se vetë KQZ-ja mund të angazhohet në marrjen e këtyre provave, kur subjekti ankimues nuk ka mundur t'i sigurojë vetë provat. Kolegji vlerëson se kjo gjë mund të realizohet atëherë kur pala në mënyrë bindëse dhe pa ekuivoqe, provon faktin se kjo provë ekziston dhe ajo është gjendur në pamundësi për të siguruar marrjen e saj dhe për këtë arsye i drejtohet KQZ-së, për marrjen e provës, si dhe është e nevojshme për të provuar faktin e pretenduar. Kolegji vlerëson të theksojë faktin se pretendimet lidhur me ekzistencën e provave që provojnë shkeljet e kryera, nuk duhet të jenë formale, në kuadër të retorikës politike. Përfundimisht Kolegji rithekson se në interpretim të ligjit zgjedhor, subjekti ankimues ka detyrimin të paraqesë provat, dhe nëse nuk ka mundur t'i sigurojë vetë, duhet të paraqesë të dhëna të mjaftueshme dhe bindëse për ekzistencën e provës pranë një institucioni të caktuar shtetëror/publik, si dhe të shpjegojë qartazi faktit që kërkon të provojë pra objektin e të provuarit dhe ndikimin e rezultatit të provës në zgjidhjen e mosmarrëveshjes së paraqitur.

38. Fillimisht Kolegji vlerëson të analizojë kërkesën e palëve paditëse z.Boiken Abazi dhe subjektit zgjedhor “*Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim*” për marrje të provave pranë institucioneve të ndryshme për të provuar pretendimet e paraqitura në këtë gjykim në lidhje me pavlefshmërinë e zgjedhjeve, kërkesa që këto palë e kishin paraqitur edhe pranë KAS-it dhe që nuk ishin pranuar me argumentin se subjektet ankues nuk kanë bërë përpjekje për të siguruar paraprakisht provat, sikurse kërkon neni 136/1/c i Kodit Zgjedhor, si dhe informacionet e kërkuara nuk gëzojnë cilësinë e provës, sipas K.Pr.Civile dhe për këtë shkak nuk mund të kërkohej si të tilla.

38.1 Kolegji kërkesën e palëve paditëse, kandidati i propozuar nga zgjedhësit Boiken Abazi, dhe subjekti zgjedhor “*Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim*”, për marrjen e informacioneve pranë institucioneve të ndryshme, të cilat i kanë konsideruar prova në mbështetje të pretendimit të tyre, (*Kolegji*) i rrëzoi në seancë gjyqësore, pasi u vlerësua se këto informacione të kërkuara për t'u marrë nuk ishin mjaftueshmërisht konkrete për nevojat e këtij gjykimi.

39. Pala paditëse kandidati i propozuar nga zgjedhësit Boiken Abazi ka parashtruar si pretendim se -*Nga fotografitë e bëra prej vëzhguesve të akredituar të kandidatit Boiken Abazi dhe nga pamjet filmike, janë paraqitur 164 fotografi të fletëve të votimit ku është vendosur një “X” i dytë shtesë, ose i tretë, në ato fletë votimit ku është vendosur një “X” për kandidatin e pavarur Boiken Abazi; dhe për të provuar këtë pretendim gjatë procesit gjyqësor i kërkoi Kolegjit marrjen e provës me anë të një eksperti me njohuri të posaçme teknike-grafike, në interpretim të neneve 224/a e vijues të Kodit të Procedurës Civile duke krahasuar shenjën e “X” –eve të gjendura në fletët e votimit të paraqitura si prova, në formën e fotove të nxjerra nga pamjet filmike të kamerave 360 gradë që qëndrojnë të numërimit.*

39.1 Në lidhje me këtë kërkim, Kolegji vlerëson se kjo palë nuk ka pasur asnjë pengesë apo pamundësi në paraqitjen përpara këtij forumi, si prove, një “opinion privat” të realizuar nga një ekspert me njohuri të posaçme, me anë të të cilit të provonte pretendimin e tij. Pë këtë arsye është rrëzuar kërkesa për marrjen e kësaj prove nga ana e Kolegjit. Si argument bindës ky Kolegji

sjell në vëmendje të paditësit vendimin nr.**Nr.00-2013-1851 i Vendimit (342) datë 06.04.2013 ku ndër të tjera është arsyetuar se: "...(...)** Për më tepër, në interpretim të neneve 224/a e vijues të Kodit të Procedurës Civile, ndonëse në aspektin thjesht formal të procedimit civil, mund të mos kualifikohet si akt ekspertimi për shkak se "eksperti" nuk është caktuar nga gjykata sipas normave procedurale, përsëri, "akti i ekspertimit" "privat" i përpiluar nga një person i licencuar rregullisht dhe paraqitur në gjykim nga një palë ndërgjyqëse, përbën një provë shkresore që mund të lidhet me zgjidhjen e çështjes" Nga ana tjetër, paditësi nuk arriti t'i tregonte Kolegjit se në ç'farë mënyre, apo masë, kjo provë do të ishte rilevante në suksesin e kërtimeve të tij, dhe si kishte ndikuar në rezultatin final të procesit zgjedhor, në lidhje me ndarjen e mandateve për Qarkun Tiranë.

39.2 Në lidhje me pretendimin për "Ekzistenca e një indicieje në shkollën "Arben Broci" në Tiranë, mund të jenë hapur kutitë e votimit dhe manipuluar fletët e votimit para se ato të dërgoheshin në Vendin e Numërimit të Votave", dhe kërkimin përpara Kolegjit për marrjen e pamjeve filmike të qëndrës së votimit, gjatë ditës së votimit apo edhe pas mbylljes së procesit të votimit, rezulton se jo vetëm që i është vënë në dispozicion nga ana e organit administrativ i cili ka marrë në shqyrtim kërkesën e tij ankimore, por kjo provë është debatuar në atë proces administrativ dhe paditësi nuk ka rezultuar i suksesshëm në pretendimet e tij, pasi në fakt mungon prova "fleta e votimit e pretenduar si e gjetur jashtë kutisë". Po kështu nga ana tjetër, nuk rezulton se për qëndrën në fjalë të jetë pretenduar nga ndonjë subjekt zgjedhor "cënim të intergritetit të kutive".

40. Duke u nisur nga ana formale, Palët paditëse në këtë gjykim kanë pretenduar se kërkesat e tyre për marrje të provave do t'i shërbenin hetimit të plotë, të gjithanshëm, dhe zgjidhjes së drejtë të mosmarrëveshjes zgjedhore duke ju referuar një procesi të rregullt ligjor, nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin" (neni 11, 14 i K.Pr.Civile).

41. Kolegji vlerëson të theksojë si argument bindës, jurisprudencën e Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut e cila në disa vendimmarrje të saj, ku janë trajtuar mosmarrëveshjet zgjedhore, ka arritur në konkluzionin se nuk mund të shqyrtohen në këndvështrimin e nenit 6 të Konventës, të cilin Gjykata e ka gjykuar të pazbatueshëm. ...kështu që mosmarrëveshjet lidhur me organizimin e ushtrimit të kësaj të drejte dalin jashtë fushës së zbatimit të nenit 6 § 1... . Neni 6 nuk hyn në veprim as në pjesën e tij penale për sa u përket sanksioneve në lidhje me mosrespektimin e rregullave të zgjedhjeve (*Pierre-Bloch k. Francës, § 50, § 61 nr. 24194/94, 21 tetor 1997*). Në lidhje me mosmarrëveshjet zgjedhore rëndësi e veçantë i kushtohet procesit të ankimit efektiv dhe gjykimi i tyre brenda një afati të arsyeshëm, me qëllim garantimin e demokracisë së një vendi.

***Pas analizës së mësipërme, dhe duke ju referuar thelbit të tyre, Kolegji analizon në vijim pretendimet e palëve paditëse për pavlefshmëri të zgjedhjeve në qarkun Tiranë.***

42. Në lidhje me pretendimet e palës paditëse kandidatit të propozuar nga zgjedhësit Boiken Abazi, dhe konkretisht : "...Kryetaret e shtatë KZAZ-vë kanë penguar hyrjen brenda Vendeve të Numërimit të Votave përkatëse gjatë kohës së pranimit të kutive në VNV, duke mos

lejuar vëzhguesit të monitorojnë procesin e pranim-dorëzimit të kutive të votimit në kundërshtim me Kodin Zgjedhor; Prania në masë brenda VNV-e, e personave të paautorizuar (të pa akredituar), përkatësisht familjarë dhe mbështetës të shtabit të kandidatëve të subjekteve të tjera zgjedhore ka shkaktuar tensione, duke ndërhyrë me fjalë deri në përdorimin e dhunës fizike; Vëzhguesit e kandidatit të pavarur z. Boiken Abazi kanë konstatuar raste kur janë shpallur të pavlefshme shumë fletë votimi pa asnjë arsytim dhe kontestimet e atypëratyshme nga vëzhguesit e kandidatit të pavarur z. Boiken Abazi nuk janë marrë parasysh nga grupi i numërimit dhe kryetari i KZAZ-së, përkatëse; Janë konstatuar raste të shumta të përdorimit të stilolapsit nga ana e grupeve të numërimit mbi tavolinën e numërimit dhe mbi fletët e votimit të cilat ndikojnë në rritja e numrit të pavlefshme; Është konstatuar mbulimi me gisht gjatë procesit të numërimit, i katrorit nën numrin 13 që i përkiste kandidatit të pavarur z. Boiken Abazi; Në ekranin e tavolinave të numërimit nuk është vendosur pamja e plotë e fletës së votimit; Refuzimi i dhënies së kopjes së procesverbaleve të nënshkruara të rezultateve të numërimit të QV-ve të vëzhguesit të kandidatit të pavarur z. Boiken Abazi dhe mos vendosja e këtyre procesverbaleve në hapësirën e përcaktuar nga KZAZ-ja përkatëse kanë çenuar dispozitën e përcaktuar në Kodin Zgjedhor.”. Kolegji vlerëson se nuk gëzojnë kapacitetin juridik që “shkelja” apo “shkeljet” të jenë të një shkalle të tillë që kanë vënë në rrezik dhe kanë çenuar zhvillimin e procesit zgjedhor sipas parimeve kushtetuese dhe atyre ligjore. Në këtë kuptim, subjekti zgjedhorë nuk arriti të provojë qartazi “shkeljen” apo “shkeljet ligjore” në procesin zgjedhor, si dhe lidhjen shkakësore të drejtëpërdrejtë midis shkeljes apo shkeljeve dhe çënimit “të rëndë të procesit zgjedhor”, që do të mund të krijonte bindjen mbi bazueshmërinë e kërimit për pavlefshmëri të zgjedhjeve në një ose më shumë qendra votimi dhe njëkohësisht do të respektonte parimin e “paprekshmërisë së procesit zgjedhor”. Kolegji vlerësoi se nëse do të provoheshin këto pretendime do të konsideroheshin parregullësi, të cilat mund të hetohen administrativisht, por kurrsesi të legjitimojnë pavlefshmërinë e procesit zgjedhor për të gjithë qarkun Tiranë.

*43. Në lidhje me pretendimin për Kundërshtimi i vendimit nr. 343, datë 04.05.2021 ‘Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për Rezultatin në zonën zgjedhore Qarku Tiranë.*

43.1 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në mbështetje të neneve 19, pika 1, shkronja “n”, e 2, dhe 123 të Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi shqyrtoi tabelat e rezultateve për subjektet zgjedhorë dhe për kandidatët për deputet, të nxjerra nga KZAZ-të e Qarkut Tiranë, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, ka vendosur me vendimin nr. 343, datë 04.05.2021 ‘Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për Rezultatin në zonën zgjedhore Qarku Tiranë :”*Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për subjektet zgjedhore, për zonën zgjedhore Qarku Tiranë, në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi...*”. Bashkëlidhur këtij vendimi ka dalë edhe Tabela Nr. 1 në të cilin pasqyrohet në numrin “13”, kandidati i propozuar nga zgjedhësit Boiken Abazi.

43.2 Pas ankimit të paditësit pranë KAS-it, në lidhje me kundërshtimin e vendimit nr. 343, datë 04.05.2021 ‘Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për Rezultatin në zonën zgjedhore Qarku Tiranë”, për shkak të mungesës së tij në këtë tabelë, nga KAS-i është arsyetuar se:”...(…) *Për sa i përket pretendimit të z. Abazi se në tabelën përmbledhëse të rezultateve mungon subjekti*

*i trembëdhjetë, kandidati i pavarur; ky pretendim nuk mbështetet, pasi tabela është vetëm për subjektet zgjedhore parti ose koalicione. KAS-i vëren se subjekti ankues ka bërë një interpretim të gabuar të rolit dhe funksionit që ka tabela në administrimin e procesit”, arsyetim i cili mbështetet edhe nga ky Kolegj. Pretendimi i mësipërm i paditësit nuk gjen mbështetje në prova dhe rezultoi se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në zbatim të nenit 123 të Kodit Zgjedhor, pasi ka verifikuar tabelat përmbledhëse të KZAZ-ve, ka nxjerrë rezultatin përfundimtar. Kjo veprimtari administrative nuk rezultoi të jetë marrë në kundërshtim me ligjin, apo të ketë ndonjë shkak të ndonjë lloji pavlefshmërie. Veprimtaritë e parregullta para kësaj vendimmarrje janë korrigjuar dhe pasojat në lidhje me palën paditëse kandidatin e propozuar nga zgjedhësit janë “shëruar”, në kohë para këtij ankimi.*

43.3 Kolegji thekson se pretendimet e palës paditëse kandidatin të propozuar nga zgjedhësit Boiken Abazi, dhe konkretisht sikurse i ka grupuar në ankimin e paraqitur para KAS-it, i) Shkelje që lidhen me pengimin e vëzhguesve; ii) shkelje që lidhen me votat e pavlefshme, iii) shkelje që lidhen me procesin e numërimit, kanë të bëjnë me konstatime të parregullësive të kryera gjatë procesit zgjedhor (votim, numërim, dhe nxjerrjes të rezultateve) në disa qendra votimi, si dhe në mbajtjen e dokumentacionit, material zgjedhor në këto qendra.

43.4 Kolegji thekson se në pjesën IX të Kodit Zgjedhor përcaktohen rregulla në lidhje me procedurën e hapjes së votimit, gjatë votimit dhe mbylljes e numërimit të votave. Përsa kanë lidhje me pretendimet në padi, neni 113 parashikon ndër të tjera se kutitë e fletëve të votimit dhe kutitë e materialit zgjedhor në përfundim të procesit të votimit mbyllet duke u vulosur me kod sigurie.

43.5 Në bazë të neneve 114 dhe 115 të Kodit Zgjedhor kutitë e fletëve të votimit dhe ato të materialit zgjedhor dorëzohen në KZAZ-të përkatëse, të cilat kryejnë numërimin e votave sipas neneve 116 dhe 116/1 të Kodit Zgjedhor. Vetëm në rast se numrat e kodeve të sigurisë të këtyre kutive nuk përputhen, apo nëse kutitë nuk kanë vula sigurie, apo më shumë kode sigurie, apo kanë hapësirë midis trupit të kutisë dhe kapakut të saj, ka thyerje ose çarje që lejon futje dhe nxjerrje të fletëve të votimit ose materialit zgjedhor, kutia është e llojit, formës dhe përmasave të ndryshme nga ato të miratuar nga KQZ, këto kuti konsiderohen të parregullta dhe nuk i nënshktrohen procesit të numërit nga gурpet e numërimit në KZAZ. Këto kuti sipas nenit 115 të Kodit Zgjedhor i dërgohen KQZ-së, e cila në bazë të nenit 138 të Kodit Zgjedhor vlerëson parregullsinë dhe sipas rastit bën numërimin fillestar të votave në kuti. Nëse nuk ka ankim për këto kuti të parregullta nga subjekt zgjedhor, atëherë këto kuti të parregullta konsiderohen të pavlefshme sipas nenit 138. Në rastet e tjera kutitë e fletëve të votimit i nënshktrohen procesit të numërimit nga KZAZ sipas nenit 116 të Kodit Zgjedhor dhe vlerësimit të votave sipas nenit 118 të këtij kodi.

43.6 Në rastin në gjykim kutitë e fletëve të votimit dhe të materialit zgjedhor të qendrave të votimit kanë rezultuar të rregullta. Kolegji thekson se mund të ndodhin parregullësi gjatë procesit të votimit dhe mbajtjes së dokumentacionit zgjedhor, por këto nuk çojnë në pavlefshmëri të zgjedhjeve në qendrën e votimit përkatëse, nëse në të nuk kanë ndodhur shkelje të rënda që çënojnë apo tjetërsojnë vullnetin e zgjedhësve të shprehur përmes votës në qendrën e votimit. Në rastin konkret parregullsitë e pretenduara në gjykim nuk janë shkelje ligjore të cilat

bëjnë të pavlefshme zgjedhjet në qendra e votimit objekt padie. Këto parregullsi nuk janë të tilla që të kenë shkaktuar paligjshmëri në ushtrimin e të drejtë së votës nga zgjedhësit.

*44. Pretendimet për paraqitje të një numri të konsiderueshëm të kallëzimeve penale pranë SPAK apo Prokurorive të rretheve gjyqësore, për konsumim të veprave penale në procesin zgjedhor.*

44.1 Kolegji i qëndron argumentimeve të bëra nga KAS në lidhje me këtë pretendim. Kolegji konsideron se paraqitja e kallëzimeve penale, jo domosdoshmërisht nënkupton se realisht është kryer një veprë penale. Prokuroritë e rretheve gjyqësore apo Prokuroria e posaçme, sipas kompetencave respektive, kanë të drejtë dhe njëkohësisht detyrim kushtetues dhe ligjor që të hetojnë veprat penale dhe të ushtrojnë ndjekjen penale ndaj kujtdo që dyshohet se kryen veprë penale, duke përfshirë edhe veprat penale që kryhen para, gjatë apo pas procesit zgjedhor. Sipas legjislacionit penal ekzistenca e kryerjes së veprës penale dhe autorësia e saj konfirmohen me një vendim gjyqësor të formës së prerë. Kolegji thekson se në gjykim nuk u paraqit asnjë provë nga palët paditëse përse i përket zonës zgjedhore/qarku Tiranë, që kryerja e krimeve të pretenduara zgjedhore ka cënuar rëndë procesin zgjedhor, duke ndikuar në vullnetin e zgjedhësve për të marrë pjesë apo jo në votime, si dhe në tjetërsimin e votës së tyre. Kolegji nuk mund të pranojë apriori pretendimin për ekzistencë të shkeljes apo shkeljeve, të ngritura në nivelin e një veprë penale, thjesht sepse është paraqitur një kallëzim penal, pasi një interpretim i tillë bie ndesh me parimin e prezumimit të pafajësisë. Aq më tepër që në çdo rast, edhe nëse do të paraqiteshin vendime gjyqësore të formës së prerë ku të evidentohet kryerja e veprave penale gjatë procesit zgjedhor, Kolegji do të vlerësonte nëse kundërligjshmëria e veprimeve (të konsideruara si veprë penale me vendim gjyqësor të formës së prerë) kishte cënuar në atë masë procesin zgjedhor, që mund të legjitimonte kërkesën për pavlefshmëri të zgjedhjeve në zonën zgjedhore përkatëse. Sa më sipër pretendimi i palëve paditëse i sipërcituar është i pabazuar në prova dhe ligj.

*45. Pretendimi mbi përdorimin e burimeve shtetërore në fushatën zgjedhore, në dhënien e lejeve të legalizimit, ndihmave, dhënie e përfitimeve nga skemat shtetërore, rritjen e punësimit, intimidimi i punonjësve të administratës shtetërore, etj;*

45.1 Kolegji duke u nisur nga natyra e pretendimeve të mësipërme, ndikimi i tyre në procesin zgjedhor, nëpërmjet moslejimit të krijimit të kushteve të drejta dhe të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që të marrin pjesë në procesin zgjedhor, i mori në analizë së bashku. Në lidhje me këto pretendim Kolegji i referohet Kodit Zgjedhor i cili përcakton në pikën 4 të nenit 91 të tij se: “1...4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore”.

45.2 Kolegji gjen me vend arsyetimin e përdorur nga KAS në lidhje me aktet përkatëse të kundërshtuara:” ...(...) *Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1076, datë 24.12.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për*



miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e ministrisë së shëndetësisë dhe njësinë mjekësore ushtarake pranë spitalit universitar të traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e forcave të armatosura”, të ndryshuar” ka dalë brenda periudhës së ndalimit dhe sjell rritje pagash për kategori të caktuara punonjësish publikë...Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1044, datë 18.12.2020 “Për një shtesë në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar” është miratuar përpara fillimit të periudhës së ndalimit, prandaj nuk përbën shkelje, sikurse miratimi i vendimit nr. 1102, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2021” nuk përbën shkelje, sepse ai është vendim procedurash dhe kriteresh lidhur me një fond që është dhënë me ligjin për buxhetin e vitit 2021. ...Shkelja e kryer në favor të subjektit zgjedhor PS me nxjerrjen e VKM nr. 1076, datë 24.12.2020 formon kundërvajtje administrative sipas nenit 172 të Kodit Zgjedhor. ...Nga pohimet e përfaqësuesve administratës së KQZ-së rezulton se PD nuk ka bërë ankim në KQZ për këtë shkelje. Në këtë kategori pretendimi bën pjesë edhe vendimi 101, datë 15.12.2020 “Autorizim i ndihmës shtetërore për fuqizimin e të rinjve dhe të rejave”. KAS konstaton se ky vendim nuk përbën kundërvajtje administrative, sepse nuk ka dalë brenda periudhës së ndalimit. ...Lidhur me pretendimin e subjektit ankues PD-AN të shprehur në paragrafin nr. 51 të kërkesës së tyre ankimore, për shpalljen e koncesionit me vendimin nr. 1185, datë 24.12.2020 të Këshillit të Ministrave “Mbi përcaktimin e metodologjisë dhe procedurave për monitorimin e trafikut në fushën e hidrokarbureve”, KAS vëren se neni 3, pika 4 e vendimit nr. 9 , datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator i referohet ndalimit të ‘dhënies së koncensionit’. Dhënia e koncensionit është procedura që kryhet në momentin që nënshkruhet kontrata midis koncensiondhënësit dhe koncensionarit. Shpallja e tenderit në vetvete nuk formon dhënie koncensionit, por është hapi i parë në fillimin e procedurave shumë mujore që përfundojnë me kontratën. Për këtë arsye, ky veprim nuk formon shkelje”.

45.3 Kolegji vë në dukje se KAS ka argumentuar se ”nga verifikimet e kryera, subjektet zgjedhore përkatës nuk kanë bërë ankim në KQZ-ë për shkeljet e pretenduara, në kuadër të konsiderimit të tyre si “kundërvajtje administrative”. Indiferenca apo moskonsiderimi nga ana e palëve paditëse, e ndjekjes së rrugës së ankimit administrativ, me justifikimin “si joefektive”, nuk ka baza të justifikueshme ligjore, për aq kohë sa ekziston në ligj apo akte nënligjore mekanizmi i ankimit dhe legjislatori ka parashikuar mundësinë e ndalimit të këtyre veprimtarive të palejuara, shoqëruar edhe më masat administrative, sipas shkeljeve të konstatuara.

45.4 Sipas nenit 12 paragrafi i 4 i Ligjit nr. 10019 datë 28.12.2008 “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Komisioni Rregullator, në vijim Rregullatori është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normative në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet. Në këtë kuadër, në lidhje me periudhën para zgjedhore me Vendimin nr. 2 datë 24.12.2020 “Rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, Agjencive, Enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara si dhe monitorimin e veprimtarisë sjedhjes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financës dhe logjistikës së administratës shtetërore para zgjedheve”, Rregullatori ka pasur si

qëllim/synim garantimin dhe sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike, krijimin e kushteve të drejta dhe të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që të marrin pjesë në procesin zgjedhor si dhe të mos përdoren fondet dhe burimet publike për qëllime politike. Ndërkohë objekti i këtij vendimi ka qenë përcaktimi i rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, procedura e shqyrtimit të tyre nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve për ndalimin e realizimit të tyre, si dhe masat administrative në rast mosrespektimit e dispozitave të Ligjit nr.10019 datë 28.12.2008 “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar. Rregullatori ka vijuar me vendimmarrjet e tij me karakter normative që kanë rregulluar jo vetëm periudhën para zgjedhore por edhe ditën e zgjedhjeve dhe periudhën paszgjedhore, administrimin e materialit zgjedhor dhe numërimin e votave, si shprehje e lirë e vullnetit të zgjedhësve.

45.5 Palët paditëse pretenduan se nga ana e subjektit Partia Socialiste, partia qeverisëse, janë përdorur ndër të tjera, burime shtetërore në fushatën zgjedhore, janë dhënë leje të legalizimit, ndihmë ekonomike, përfitime nga skemat shtetërore, rritja e njerëzve të punësuar, si dhe janë intimiduar punonjësit e administratës publike në kundërshtim me Kodi Zgjedhor dhe vendimin nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator të KQZ-së, ndërkohë që ka rezultuar se asnjë prej këtyre veprimtarive të ndaluara, nuk është referuar pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me qëllim hetimi administrativ.

45.6 Duke iu referuar pretendimit të palëve paditëse, Kolegji vlerëson se ato nuk arritën të provonin se pikërisht miratimi i këtyre akteve nënligjore/administrative në vetvete, kishte cënuar rëndë procesin zgjedhor, me pasojë ndryshimin e votës së zgjedhësve në atë masë sa të kishte ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore përkatëse. Vlerësimi i ndikimit të këtyre akteve, në këtë moment kohor (*pra pas procesit zgjedhor*), është i pamundur, paragjykes dhe hipotetik, jo i matshëm dhe jo konkret, dhe për më tepër vjen në kundërshtim me prezumimin ligjor të votës së fshehtë.

45.7 Në vlerësim të Kolegjit, nuk mund të disponohet mbi pavlefshmërinë e zgjedhjeve sa kohë nuk provohet shkelja me anë të provave reale dhe të drejtëpërdrejta, apo një lidhje e drejtë për drejtë dhe shkakësore e tyre, me ndryshimin e vullnetit të zgjedhësve, në një masë kritike, që të jetë bërë përcaktuese në ndikimin e vullnetit të zgjedhësve. Sa më sipër, ky pretendim i palëve paditëse do të konsiderohet i pabazuar në prova dhe ligj.

46. *Pretehimet në lidhje me pamundësinë e votimit të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit dhe të karantinuar.*

46.1 Pala paditëse parashtron se mosgarantimi i të drejtës për votim të shtetasve shqiptar me banim jashtë vendit ka cënuar rëndë procesin zgjedhor dhe për pasojë zgjedhjet e qarkut Tiranë duhet të shpallen të pavlefshme. Kodi zgjedhor ka parashikuar mundësinë që edhe shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit, t`u garantohet e drejta e votës. Siç ka argumentuar KAS-i në vendimin objekt gjykimi, në nenin 20/1/dh të Kodit Zgjedhor përcaktohet kompetenca e Komisionit Rregullator (*që janë të zgjedhur nga Kuvendi*) për të shqyrtuar dhe miratuar aktet me karakter normativ lidhur me rregullat për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit, për procedurat e votimit të tyre, administrimin dhe numërimin e votave etj. Sipas vendimit të KAS-

it, konstatohet se për zgjedhjet e përgjithshme të datës 25.04.2021, kjo gjë nuk është realizuar nga ana e Komisionit Rregullator dhe rrjedhimisht nuk është mundësuar votimi i shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit.

46.2 Kolegji thekson se jemi në kushtet kur pamundësia e realizimit të votimit të shtetasve shqiptarë jashtë vendit (*në vendet ku jetojnë*) nuk do të mund të konsiderohet shkelje që passjell pavlefshmëri të zgjedhjeve në qarkun Tiranë. Mungesa e akteve ligjore apo nënligjore për rregullimin e procesit të votimit jashtë vendit, nuk mund të konsiderohet si “shkelje” të ligjit. Nuk argumentohet dhe nuk provohet nga pala paditëse lidhja shkakësore midis një situatë të mosrealizimit të procesit të votimit për shtetasit shqiptarë që banojnë jashtë vendit, me cënimin e pretenduar të procesit zgjedhor në qarkun Tiranë. Pikërisht, mosmarrja e masave për të mundësuar ushtrimin e së drejtës së votës nga shtetasit shqiptarë jashtë vendit, në shtetet që jetojnë, nuk mund të passjellë shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në zonën zgjedhore përkatëse, duke mohuar të drejtën e votuesve që kanë ushtruar të drejtën e votës. Ky është një pretendim që nuk mund të paraqitet para Kolegjit dhe pas pjesëmarrjes në zgjedhje të subjektit zgjedhor. Nëse do të pranohej ky pretendim i palëve paditëse nuk duhet të ishin zhvilluar zgjedhjet e 25 prillit 2021 nëse nuk do ishte rregulluar me akt normativ të Komisionit Rregullator, votimi i shtetasve shqiptar që jetojnë jashtë vendit. Për më tepër, sipas këtij interpretimi të palëve paditëse, jo vetëm këto zgjedhje do të ishin të pavlefshme, por të tilla do të vijonin të ishin, derisa të miratohej një akt normativ për votimin e zgjedhësve me banim jashtë vendit. Pa analizuar më tej Kolegji, thekson se mosvotimi i zgjedhësve me banim jashtë vendit nuk përbën shkak për pavlefshmëri të zgjedhjeve në kuptim të nenit 160 të Kodit Zgjedhor.

46.3 Në vijim të argumentit të mësipërm, si autoritet bindës Kolegji sjell në vëmendje jurisprudencën e GJEDNJ-së. Në disa çështje Gjykata e ka përsëritur pajtueshmërinë e imponimit të një kriteri vendbanimi me nenin 3 të Protokollit nr. 1. Atë mund ta përlligjin disa arsye: *së pari*, prezumimi se një qytetar jo me banim aty është i interesuar më pak drejtpërsëdrejti ose më pak vazhdimisht për problemet e përditshme të vendit të tij si edhe i njeh më pak ato; *së dyti*, kandidatët për zgjedhjet legjislativë nuk kanë kurrfarë mundësie që t’ua paraqesin sfidat e ndryshme zgjedhore qytetarëve që ndodhen jashtë shtetit dhe këta të fundit kanë më pak ndikim në përzgjedhjen e kandidatëve apo në përcaktimin e programeve të tyre zgjedhore; *së treti*, lidhja e ngushtë ndërmjet së drejtës së votës në zgjedhjet legjislativë dhe faktit që prekesh drejtpërdrejt nga aktet e organeve politike të zgjedhura në këtë mënyrë; dhe, *së katërti*, shqetësimi i drejtë që mund të ketë ligjvënësi për ta kufizuar ndikimin e qytetarëve me banim jashtë shtetit mbi zgjedhje që kanë të bëjnë me disa pika të cilat, ndonëse duke qenë sigurisht themelore, prekin në radhë të parë personat që janë me banim brenda vendit. Edhe sikur personi i interesuar të mos i ketë shkëputur ndoshta lidhjet me vendin e tij të prejardhjes e sikur disa prej elementeve të sipërpërmendur, për rrjedhojë, të mos kenë mbase të bëjnë me të, ligji nuk mund të marrë gjithmonë parasysh secilin rast individual, por duhet të parashtrojë një rregull të përgjithshëm (*Hilbe k. Lihtenshtajnit*, 31981/96, GjEDNJ 1999-VI); (*Doyle k. Mbretërisë së Bashkuar*, (vend. pran.), nr. 30158/06, 6 shkurt 2007); (*Shindler k. Mbretërisë së Bashkuar*, § 105, nr. 19840/09, 7 maj 2013). Në vijim të kësaj praktike, Neni 3 i Protokollit nr. 1 nuk ua vë shteteve në ngarkim detyrimin për të vendosur një sistem që mundëson ushtrimin e së drejtës së votës jashtë shtetit për këtë kategori qytetarësh.

47. *Pretendimi në lidhje me Urdhrin nr. 219 datë 19.04.2021 “Për karantinimin e personave që vijnë në R.Sh. nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia”, nxjerrë nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, u është mohur e drejta e votimit shtetasve shqiptar që jetojnë në këto shtete;*

47.1 Palët paditëse pretenduan se zgjedhjet në qarkun Tiranë duhet të shpallen të pavlefshme për shkak se me Urdhrin nr. 219 datë 19.04.2021 “Për karantinimin e personave që vijnë në R.Sh. nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia”, nxjerrë nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, u është mohur e drejta e votimit shtetasve shqiptar që jetojnë në këto shtete. Kolegji thekson se siç ka argumentuar KAS, urdhri në fjalë, është kundërshtuar gjyqësisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe në Gjykatën Administrative të Apelit nga subjekti ankues LSI-ja, por nuk është disponuar për shfuqizimin apo ndryshimin e tij. Kolegji vë në dukje se urdhri ka qenë në fuqi dhe është nxjerrë, për të parandaluar përhapjen e virusit SARS COV 2, në kuadër të masave që janë marrë përgjatë periudhës së pandemisë “COVID 19 duke parashikuar karantinimin 14 ditor për shtetasit që hyjnë në Shqipëri nga Republika e Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut gjatë periudhës 20.04.2021 deri më 03.05.2021.

47.2 Kolegji vlerëson të theksojë se Neni 3 i Protokollit nr. 1, i sipërcituar, ndryshon nga dispozitat e tjera të Konventës dhe të Protokolleve të saj të cilat garantojnë të drejta, sepse ai parashtron detyrimin që kanë shtetet anëtare për të organizuar zgjedhje brenda kushteve që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit dhe jo ndonjë të drejtë apo liri në veçanti. Të drejtat në fjalë nuk janë absolute. Në to ka vend për disa “kufizime të nënkuptuara”, dhe Shteteve Kontraktuese duhet t’u lihet një hapësirë për vlerësim në këtë lëmë. Nocioni “kufizim i nënkuptuar” do të thotë gjithashtu se Gjykata nuk i zbaton kriteret tradicionale të “domosdoshmërisë” ose të “nevojës së ngutshme shoqërore” që përdoren në suazën e neneve 8 deri në 11 të Konventës. Kur i duhet të shqyrtojë pika rreth përputhshmërisë me nenin 3 të Protokollit nr. 1, Gjykata vlerëson kryesisht dy kritere: i) ajo sheh në njërin anë se mos ka pasur arbitraritet ose mungesë përpjesëtueshmërie, dhe në anën tjetër se ii) mos kufizimi e ka cenuar shprehjen e lirë të mendimit të popullit. (Mathieu-Mohin e Clerfayt k. Belgjikës, § 52, 2 mars 1987, seria A nr. 113; Ždanoka k. Letonisë [DhM], §§ 103-104 et 115, nr. 58278/00, GjEDNj 2006-IV).

47.3 Kolegji thekson se urdhri i mësipër është nxjerrë dhe i referohet periudhës së festave fetare (Pashkët), periudhë gjatë së cilës normalisht kontaktet midis njerëzve janë më të shumta dhe rrjedhimisht pasohet me shtim të udhëtimeve ndërshtetase. Kolegji vlerëson se nxjerrja e këtij urdhëri është një kufizim proporcional në kuptim të mbrojtjes së të drejtave sikurse është e “drejta e jetës dhe shëndetit” të qytetarëve në situatën konkrete, por edhe të shprehjes së lirive të tjera të garantuara, duke mospenguar pjesëmarrjen në votime të qytetarëve të shëndetshëm, për shkak të frikës nga infektimet. Kolegji vlerëson se pala paditëse nuk provon se nxjerrja e këtij urdhri ka patur ndikim të atillë në procesin zgjedhor në qarkun Tiranë, ka “cenuar shprehjen e lirë të mendimit të popullit” sa të mund të disponohet mbi pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Pra, pretendimi është hipotetik dhe i përgjithshëm pa u provuar çënimi i rëndë i

pretenduar i procesit zgjedhor në qarkun Tiranë. Sa më sipër, ky pretendim është i pabazuar në prova dhe ligj.

47.4 Pala paditëse ka pretenduar se në ditën e zgjedhjeve kanë qenë 23,000 të infektuar me “COVID 19” dhe kjo gjë ka passjellë pamundësinë e ushtrimit të së drejtës së votës nga ana e tyre, duke u konsideruar si një mohim *de facto* i së drejtës për të votuar. Kolegji vë në dukje se Kodi Zgjedhor, nuk parashikon mundësinë e votimit në distancë për zgjedhësit që ndodhen në territorin shqiptar. Kolegji vë në dukje se në kuadër të mospërhapjes së virusit SARS COV 2 janë miratuar rregulla ligjore për izolim të personave të infektuar. Kolegji vlerëson se në situatën pandemike COVID-19, duke pasur parasysh synimin për mbrojtjen e të drejtës së jetës dhe shëndetit, mosvotimi i personave të sëmurë me virusin SARS COV 2, duke qenë se kanë qenë në izolim, nuk konsiderohet shkelje e tillë që çënon rëndë procesin zgjedhor, me pasojë pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qarkun Tiranë. Madje nuk provohet sesa ndikim ka pasur ky numër në shkallë vendi në qendrat e votimit në qarkun e Tiranës dhe sa prej tyre kanë qenë zgjedhës dhe madje në këtë qark. Sa më sipër, ky pretendim është i pabazuar në ligj dhe prova.

*48. Pretendimet për krijimin, nga ana e subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, të një bazë të dhënash personale (database) për një numër të konsiderueshëm zgjedhësish.*

48.1 Pala paditëse pretendon se mbajtja e të dhënave për një numër të konsiderueshëm të zgjedhësve, në të cilat gjenin pasqyrim në mënyrë aluduese preferencat politike, i njohur ndryshe, referuar edhe nga jehona në media që pati ky lajm, “*skandali i patronazhistëve*”, ka ndikuar në vullnetin e votuesve duke bërë zgjedhjet e pavlefshme në qarkun Tiranë.

48.2 Kolegji thekson se pala paditëse nuk provoi në gjykim ndikimin e strategjisë së pretenduar se është ndjekur lidhur me “*patronazhistët*”, tek personat që kanë ushtruar të drejtën e votës duke ndikuar mbi vullnetin e zgjedhësve për pjesëmarrje në votime apo për preferencat e tyre përkundrejt partive politike në qarkun Tiranë. Kolegji vë në dukje se të dhënat personale duhet të mbrohen sipas parashikimeve të ligjit nr.9887/2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, ku parashikohen mekanizmat apo rrugët ligjore që ndiqen për të garantuar mbrojtjen e tyre.

48.3 Në vijim, referuar natyrës së këtij gjykimi, Kolegji nuk e gjen me vend të argumentojë më tej lidhur me këtë pretendim të paraqitur në gjykim, pasi në kompetencë të Kolegjit është vlerësimi nëse “*fenomeni*” i pretenduar si më lart, i konsideruar si shkelje nga pala paditëse, ka ndikuar ose jo në një masë të rëndë në çënimin e procesit zgjedhor. Kolegji vlerësoi se nuk provohet që ky fenomen të ketë ndikuar në vullnetin e zgjedhësve për pjesëmarrje në votime apo lidhur me preferencat e tyre partiake në qarkun e Tiranës.

*49. Pretendimet në lidhje me fenomenin e “shitblerjes së votës”, “përfshirjes në fushatën zgjedhorë të personave me rekorde kriminale”, tenderat prokurimet publike për individë me rekorde kriminale në këmbim të mbështetjes politike për zgjedhjes, apo blerja e votive nëpërmjet ndihmave ushqimore dhe përfitimeve të tjera.*

49.1 Kolegji vlerëson se në lidhje me këto pretendime, që në vetvete mund të përbëjnë “*vepra penale*” ose “*veprimtari të palejuara*” sipas Vendimit nr. 9/20202 të Rregullatorit, mban të njëjtin qëndrim si më sipër ka arsyetuar (*referoju pikave 44 dhe 45 të këtij vendimi*). Kolegji

gjithësesi, konsideron të ndalet në argumentet e përdorura nga palët paditëse, që pretendimet e tyre për pavlefshmëri të zgjedhjeve provohen edhe nga “gjetjet” apo “deklaratat publike” të bëra nga ndërkombëtarët/misioni vëzhgues i OSBE/ODIHR. KAS-i në vendimin objekt gjykimi ka argumentuar se:”...(...) në deklaratën e Misionit vëzhgues të OSBE/ODIHR-it për gjetjet dhe konkluzionet paraprake, të datës 26.04.2021 përmbahen gjetje dhe të dhëna për shitblerjen e votës dhe për përdorimin e burimeve shtetërore, të cilat janë referuar në kërkesën ankimore. ....Gjetjet dhe konkluzionet paraprake të deklaratës janë të besueshme dhe të pranueshme. ... Në vlerësimin e tij të përgjithshëm Misioni vëzhgues ka konstatuar se edhe në këto zgjedhje “mbetën problem praktikat gjerësisht të përhapura të blerjes së votës” (faqe 2), sikurse ka konsideruar të besueshme “raportimet sipas të cilave koordinatorët e partive të mëdha u ishin afruar për t’u blerë votat një numri domethënës votuesish nga komunitetet rome dhe egjiptiane (faqe 16). Deklarata eidenton faktin se “ministrat vijuan fushatën përgjatë veprimtarive zyrtare dhe me këtë publicitet i dhanë përparësi domethënëse partisë qeverisëse”, sikurse thekson se ishin shqetësim dhënia e iniciativave dhe pretendimet për presion mbi nëpunësit publikë (faqe 2)... Sipas gjetjeve dhe konkluzioneve të kësaj deklarate të ODIHR-it, ka përhapje të fenomenit, blerja e votave është e pranishme si metodë së paku tek partitë e mëdha. Gjithsesi, përmasat e këtyre fenomeneve nuk formojnë, në gjykimin e misionit vëzhgues, shkak për pavlefshmëri, përndryshe deklarata nuk do t’i konsideronte zgjedhjet si zgjedhje ku “votuesit mund të zgjidhnin midis kandidatësh, të cilët mund të bënin lirshëm fushatë, me një kuadër ligjor që respekton liritë themelore” dhe ku “zgjedhjet ishin në përgjithësi të mirorganizuar” (faqe 1). Kolegji vlerëson se misionet vëzhguese, ndër të tjera, me konstatimet e tyre, ndihmojnë në evidentimin e problematikave që janë shfaqur gjatë një procesi zgjedhor, si dhe në marrjen e iniciativave, në të ardhmen, për ndryshime ligjore apo në krijimin e mekanizmave të përshtatshëm, për të përmirësuar sistemin zgjedhor. Kolegji, pa analizuar më gjatë, bazuar në analizën e sipërpërmendur të KAS-it, i gjen pretendimet e palës paditëse për të provuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qarkun Tiranë përmes gjetjeve të misionit vëzhgues të OSBE/ODIHR-it, të pabazuar në nenin 160 të Kodit Zgjedhor.

49.2 Pala paditëse pretendoi se në qarkun e Tiranës si në qarqe të tjera është vënë re fenomeni i shitblerjes së votës dhe përfshirjes në fushatë të personave me precedent penal dhe për këtë fenomen ka paraqitur kallëzime penale në prokurori në rrethe dhe në SPAK. Sipas palës paditëse, ky fenomen është konstatuar edhe në Deklaratën e Gjetjeve dhe Rekomandimeve Paraprake të OSBE/ODIHR-it. Kjo sipas palës paditëse ka cënuar rëndë procesin zgjedhor dhe për pasojë i bën të pavlefshme zgjedhjet në qarkun e Tiranës. Kolegji vë në dukje se këto pretendime janë të përgjithshëm dhe të tilla që nuk provojnë rast konkret të ndikimit në shtrembërimin e votës së votuesve dhe rrjedhimisht në cënimin të rëndë të procesit zgjedhor në qarkun Tiranë. Kolegji vlerëson se nga pala paditëse, nuk u arrit që të argumentohet lidhja shkakësore midis fenomenit të “shitblerjes së votës” apo “përfshirjes në fushatë zgjedhore të personave me rekorde kriminale”, e më tej, edhe sikur të provohej ky pretendim, me pasojën e ardhur në cënim të procesit dhe rezultatin konkret të zgjedhjeve.

49.3 Kolegji rithekson se pavlefshmëria e zgjedhjeve duhet të bazohet në prova që qartësisht eidentojnë cënimin e rëndë të procesit zgjedhor nga veprimet e kryera në shkelje të ligjit dhe jo të bazohet në hamendësime të përgjithshme. Kolegji nuk mund të pranojë apriori

pretendimin për ekzistencë të shkeljes apo shkeljeve, të ngritura në nivelin e një vepre penale, thjesht sepse është paraqitur një kallëzim penal. Sa më sipër, Kolegji e gjen pretendimin të pabazuar në prova dhe ligj.

*50. Pretendimet për përdorimin e fondeve publike për fushatën zgjedhore, investimet publike, rindërtimi në funksion të P.S për zgjidhet (përsëritur në të gjithë vendin 120 herë), kërcënimi i votuesve për mbyllje të bizneseve të tyre nëpërmjet inspektimeve të paligjshme, transferimi i paligjshëm i gjendjes civile për të rritur numrin e votuesve në zona të caktuara etj.*

50.1 Kolegji vë në dukje se pala paditëse nuk provon lidhjen shkakësore midis këtyre veprimtarive me pasojën që pretendohet se ka ardhur dhe konkretisht cënimi të rëndë të procesit zgjedhor në qarkun Tiranë. Kolegji vë në dukje se veprimtari të tilla të pretenduar të kryera në kundërshtim me rregullimet e Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator të KQZ, (*referoju pikës 45 më sipër*), nuk provohet nga pala paditëse se kanë pasur ndikim në pjesëmarrjen e zgjedhësve në votime dhe në preferencat politike të tyre, apo të identifikojnë preferencën me qëllim analizimin në lidhje me pasojën e kërkuar “ndarjen e mandateve”. Përsa kohë që nuk arrihet të provohet cënimi konkret i procesit zgjedhor në qendrat e votimit të qarkut Tiranë nga këto veprimtari të ndaluara, atëherë pretendimi për pavlefshmëri të zgjedhjeve në të gjitha qendrat e qarkut Tiranë është i pabazuar në prova dhe ligj.

50.2 Kolegji gjen me vend të ritheksoj së pretendimet në lidhje me këto “fenomene” të pretenduara se kanë ndodhur, citohen në mënyrë të përgjithshme dhe nuk faktojnë ndikimin mbi procesin zgjedhor, në atë nivel, që mund të passjellin pavlefshmëri të zgjedhjeve. Kolegji rithekson se pala paditëse në kuptim të nenit 160 të Kodit Zgjedhor duhet të provonte ndikimin në procesin zgjedhor në një qendër votimi ose disa të tilla të caktuara të veprimtarinë ndaluese konkrete që pretendohet se është kryer. Kolegji rithekson se pavlefshmëria e zgjedhjeve duhet të bazohet në prova, që qartësisht evidentojnë cënimin e rëndë të procesit zgjedhor nga veprimet e kryera në shkelje të ligjit dhe jo të bazohet në hamendësime të përgjithshme dhe të pafaktuara. Sa më sipër, Kolegji e gjen pretendimin të pabazuar në prova dhe ligj.

*51. Pretendimet mbi miratimin e ndryshimeve kushtetuese me ligjin nr.115/2020, ndryshimeve në ligjin “Kodi Zgjedhor” me ligjin 118/2020, pa pëlqim të subjektit ankues.*

51.1 Pala paditëse ka pretenduar se ndryshimet e njëanshme të Kodit Zgjedhor nga Partia Socialiste kanë shkelur marrëveshjen konsensuale me KQZ-në, që u evidentuan si problematikë edhe nga Misioni i OSBE/ODIHR. Sipas palës paditëse në opinionin e tyre të përbashkët, Komisioni i Venecias të Këshillit të Evropës dhe ODIHR-i shprehën keqardhje që procedurat e miratimit të ndryshimeve në Kushtetutë dhe në Kodin Zgjedhor kishin qenë jashtëzakonisht të nxituara dhe që nuk ishin paraprirë nga një proces i duhur konsultimi. Kolegji vë në dukje se pretendimi për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qendrat e votimit të qarkut Tiranë për shkak të ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore në mënyrë të njëanshme nga PS, nuk gëzon kapacitetin juridik për t’u konsideruar “shkelje” që ka dëmtuar rëndë procesin zgjedhor në kuptim të nenit 160 të Kodit Zgjedhor.

*52. Pretendimet për përqindje, të konsideruar të lartë, të votave të pavlefshme.*

52.1 Sipas palës paditëse numri i votave të pavlefshme në zgjedhje ishte 83.028 vota ose 5% e numrit total të votuesve dhe vetëm për Qarkun e Tiranës ishin 18399 ose 3.79 % vota të pavlefshme. Pala paditëse pretendon se ky fakt është ndikuar nga përmbajtja e fletës së votimit me numra dhe jo me emrat e kandidatëve, duke krijuar konfuzion ditën e zgjedhjeve. Sipas palës së paditur kjo ka çuar në mohim të së drejtës së votës së lirë të zgjedhësve dhe deformim të rezultatit të zgjedhjeve dhe për pasojë kërkon pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qendrat e votimit të qarkut Tiranë. Kolegji me vendimin nr.5 datë 04.04.2021, është shprehur lidhur me pretendimet e subjekteve zgjedhorë mbi përmbajtjen e fletës së votimit. Kolegji thekson se nuk u provua nga pala paditëse lidhja midis evidentimit dhe konstatimit të votave të pavlefshme me cënimin e procesit zgjedhor në këtë qark.

52.2 Kolegji vë në dukje se ashtu sikurse ka arsyetuar KAS-i, pavlefshmëria e votave (*duke marrë parasysh edhe faktin se vota është e fshehtë*), nënkupton edhe pamundësinë e evidentimit të vullnetit real të zgjedhësve dhe për pasojë edhe pamundësinë e verifikimit të cënimit real të secilit subjekt zgjedhor. Kolegji thekson se palët paditëse nuk arritën të provonin lidhjen midis evidentimit të një përqindje të caktuar të votave të pavlefshme dhe cënimit të rëndë të procesit zgjedhor në qarkun Tiranë.

52.3 Kolegji rithekson se pavlefshmëria e zgjedhjeve duhet të bazohet në prova që qartësisht evidentojnë cënimin e rëndë të procesit zgjedhor nga veprimet e kryera në shkelje të ligjit dhe jo të bazohet në hamendësime të përgjithshme dhe të pafaktuara. Sado që neni 3 i Protokollit nr. 1, e nënkupton parimin e barazisë së trajtimit të të gjithë qytetarëve në ushtrimin e së drejtës së tyre të votës, prapëseprapë kjo nuk do të thotë se të gjitha votat duhet të kenë një peshë të barabartë për sa i takon rezultatit. Kështu, asnjë sistem nuk e shmang dot dukurinë e “votave të shkuara dëm” (*Partija “Jaunie Demokrati” e Partija “MËsu Zeme” k. Letonisë § 54, (vend. pran.), nr. 10547/07 e 34049/07, 29 nëntor 2007*). Sa më sipër, Kolegji e gjen pretendimin të pabazuar në prova dhe ligj.

53. *Pretendimi për kryerjen e votimeve të shumëfishta, pas kontrollit të kryqëzuar të të dhënave PEI;*

53.1 Pala paditëse ka pretenduar se ka patur parregullsi në administrimin e pajisjeve të përdorura për identifikimin e zgjedhësve, të cilat kanë lidhje me regjistrimin e një gjurme daktiloskopike për më shumë se një identitet zgjedhësi, sikurse ka pasur raste të personave me identitet me gjurmë daktiloskopike të njëjta në dy qendra votimi të ndryshme. Sipas palës paditëse kjo përbën shkak për pavlefshmëri të zgjedhjeve në qendrat e votimit të qarkut Tiranë.

53.2 Kolegji thekson se KAS-i në vendimmarrjen objekt gjykimi parashtroi se: “*...(...) Rezultatet e servirura në material formojnë indicie për hetimin administrativ të KQZ-së, por nuk formojnë dot prova për të mbështetur pretendimin e subjekteve ankuese “ për raste të shumta të votimit të dyfishtë”. Materiali i servirur konstaton se për zonën zgjedhore ka një listë prej 123 rastesh të identifikuar me gjurmë daktiloskopike të dyshuara të njëjta nga pajisjet, por jo të përputhshme. Nëse gjurmët do ishin të përputhshme, atëherë pajisja do t’i kish deklaruar të përputhshme ato. Në 51 raste ky dyshim përqas gjurmën daktiloskopike me identitetin e njëjtë në dy qendra votimi të ndryshme. Mbi bazën e informacionit të përftuar nga materiali i servirur mund të ngrihen vetëm hipoteza për sjelljen e zgjedhësve të evidentuar por nuk mund të krijohet*



*bindja për shkelje të provuara, aq më tepër për votim të dyfishtë. Nga palët në proces u argumentua se materiali i servirur provon se administrimi i procesit nga operatorët ka qenë i parregullt. KAS-i çmon se ky pretendim nuk ka lidhje me pretendimin për votim të shumëfishtë për të cilin ishte kërkuar marrja e provës. Ky material dhe stadi aktual i hetimit administrativ të KQZ-së nuk e provon pretendimin për votim të shumëfishtë”.*

53.3 Kolegji i gjen argumentat e mësipërme të KAS-it të bazuara. Konkretisht, nga vetë KAS pranohet se nga rezultatet e marra krijohen indicie për kryerje të verifikimeve të tjera, por nuk është provohet as nga pala paditëse ekzistenca e fenomenit të “*votimit të shumëfishtë*”. Për më tepër, nuk u arrit të provohej konkretisht, se cilat ishin këto raste konkrete të votimit të pretenduar të shumëfishtë, që kishin ndikim të tillë në procesin zgjedhor, sa të psjellin për pasojë pavlefshmëri të zgjedhjeve në qendrat e votimit të qarkut Tiranë. Sa më sipër, Kolegji e gjen pretendimin të pabazuar në prova dhe ligj.

#### *54. Pretendim për diskriminimi i kandidatëve gjatë procesit zgjedhor*

54.1 Sipas palës paditëse ligji zgjedhor u lejon vetëm Kryetarëve të partive, por asnjë kandidat tjetër që të kandidojë deri në 4 zona zgjedhore, ndërkohë që kandidatët e tjerë mund të kandidojnë vetëm në një zonë, gjë që përbën shkelje të së drejtës së kandidimit në kushte të barabarta, ky fakt, përbën një diskriminim në të drejtën për t’u zgjedhur, në kuptim të neneve 18 dhe 45 të Kushtetutës. Kolegji vë në dukje se pretendimi i mësipërm i palës paditëse për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qendrat e votimit të qarkut Tiranë, nuk ka bazë sipas parashikimit të nenit 160 të Kodit Zgjedhor.

54.2 Më tej akoma, Kolegji vlerëson të sjellë në vëmendje të palëve Jurisprudencën e GjEDNj-së, e cila thekson se, *-ashtu si aspekti “aktiv”, aspekti “pasiv”, e drejta për të qenë kandidat në zgjedhje, ...është “e pandashme nga nocioni i regjimit me të vërtetë demokratik” (Podkolzina k. Letonisë, § 35, nr. 46726/99, GjEDNj 2002-II). Mirëpo kontrolli i ushtruar nga Gjykata lidhur me këtë aspekt të neni 3 të Protokollit nr. 1 është më pak i rreptë sesa ç’është për sa i përket së drejtës së votës; kontrolli i përpjesëtueshmërisë është më pak i thellë. Shtetet gëzojnë pra në këtë fushë një hapësirë vlerësimi më të gjerë sesa kur bëhet fjalë për aspektin “aktiv” (Etxeberria me të tjerë k. Spanjës, § 50, nr. 35579/03 e 3 të tjerë, 30 qershor 2009). ...Megjithatë, ndalimi i diskriminimit, i parashikuar nga neni 14 i Konventës, edhe këtu nuk zbatohet më pak. Por, në këtë kontekst, ndonëse hapësira për vlerësim që u njihet zakonisht shteteve në fushën e së drejtës për të qenë kandidat në zgjedhje është e gjerë, në qoftë se dallimi në trajtim bëhet mbi bazë race, ngjyre ose prejardhjeje etnike, nocioni i përlijjes objektive dhe të arsyeshme duhet të interpretohet në mënyrë sa më të rreptë (Sejdić e Finci k. Bosnjë-Hercegovinës [DhM], § 44, nr. 27996/06 e 34836/06, GjEDNj 2009).*

54.3 Nuk rezulton se ka të dhëna për ndonjë “*diskriminim*” nga ligji zgjedhor, kur ai u lejon vetëm Kryetarëve të partive kandidimin në më shumë se një zonë, pasi ndjek qëllime të tjera, të ndryshme nga dallimi mbi bazë race, ngjyre ose prejardhjeje etnike.

55. Sa më sipër, Kolegji arrin në përfundimin se shkeljet e pretenduara se janë kryer për një pjesë nuk u provua ekzistenca e tyre dhe për pjesën tjetër nuk u prova se kanë ndikuar në cënimin e rëndë të procesit zgjedhor që të bëj të pavlefshme zgjedhjet në të gjitha qendrat e

votimit në qarkun Tiranë. Sa më sipër, Kolegji arrin në përfundimin se paditë e paraqitura nga kandidati i propozuar nga zgjedhësit **Boiken Abazi** dhe subjekti “**Partia Demokratike Aleanca për Ndryshim**”, janë të pambështetura në prova dhe në ligj dhe për pasojë duhen rrëzuar.

**PËR KËTO ARSYE**

*Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në Ligjin nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i përditësuar,*

**V E N D O S I**

- Rrëzimin e padive të palëve paditëse **Boiken Abazi** dhe “**Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim**” si të pabazuara në prova dhe në ligj.
- Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
- U shpall në Tiranë, sot më datë **08.06.2021**.

**GJYQTARE**

**Manjola XHAXHO**

**GJYQTAR**

**Gentian MEDJA**

**GJYQTARE**

**Emona MUÇI**

**GJYQTARE**

**Alma KOLGJOKA**

**GJYQTAR**

**Asim VOKSHI**